

PLANI SOCIAL 2024-2026

BASHKIA BERAT

PERMBAJTJA

HYRJE	3
METODOLOGJIA	3
LEGJISLACIONI	5
1. ANALIZA E GRUPEVE NË NEVOJË DHE SHËRBIMEVE EGZISTUESE	8
1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM.....	8
2. INDIVIDË NË NEVOJË PËR SHËRBIME DHE SHËRBIMET EGZISTUESE.....	10
2.1. Në familje pa të ardhura/me të ardhura të pamjaftueshme.....	10
2.2. Persona me aftësi të kufizuara.....	14
2.3. Viktima të dhunës në familje.....	18
2.4. Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje.....	21
2.5. Familjet rome dhe egjiptiane.....	22
2.6. Të moshuarit në nevojë për shërbime sociale	23
2.7. Personat me varësi nga droga dhe nga alkooli	24
3. KAPACITETET E BASHKISË.....	25
3.1 Burimet njerëzore.....	25
4. ANALIZA SWOT	27
5. MISIONI, VIZIONI DHE PARIMET UDHËRRËFYESE.....	27
5.1 Misioni	27
5.2 Vizioni.....	27
6. QËLLIMET, OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET	29
7. PLANI I VEPRIMIT.....	47
8. MONITORIMI DHE VLERËSIMI	70
9. PËRMBLEDHJE E BUXHETIT	70
10. SHTOJCAT.....	72
10.1 REFERENCAT	72
10.2 SHTOJCA BUXHETI I DETAJUAR.....	74

HYRJE

Në respekt të kuadrit ligjor kombëtar dhe detyrimeve e angazhimeve të vetë Bashkisë Berat për t'ju përgjigjur nevojave në ndryshim të komuniteteve vendore përmes shërbimeve specifike të ngritura e funksionale në territorin e saj, në periudhën Qershor-Nëntor 2023 Drejtoria e Shërbimit Social të kësaj Bashkie ndërmorri procesin e vlerësimit të nevojave për shërbime sociale dhe të hartimit të Planit Social për periudhën 2024-2026.

Për realizimin e këtij procesi Bashkia Berat u mbështet nga UNDP dhe Programi “Askush të Mos Mbetet Pas 2”, mbështetje që vjen në vijim të bashkëpunimit disa vjeçar që ka mundësuar si ngritje të kapaciteteve të stafeve sociale ashtu dhe të ngritjes së shërbimeve sociale në këtë Bashki. Qasja e përdorur nga UNDP për të mbështetur Bashkinë në hartimin e këtij Plani mundësoi jo vetëm mbështetjen e strukturës lokale në procesin e përgatitjes, por edhe të zhvillimit të kapaciteteve të tyre për ta realizuar me burimet e saj në të ardhmen këtë proces.

Plani Social i Bashkisë Berat për periudhën 2024-2026 ngrihet mbi eksperiencën e zhvilluar ndër vite nga kjo Bashki si në këndvështrimin e identifikimit të individëve në nevojë për shërbime, zhvillimit të partneritetit me institucione e organizata për të maksimalizuar efektin e ndërhyrjeve në favor të grupeve vulnerabël, ashtu edhe të shërbimeve sociale që janë ngritur gradualisht dhe funksionojnë në këtë Bashki. Masat e parashikuara në këtë Plan do të rritin efektivitetin e sistemit komunitar të shërbimeve sociale në këtë Bashki përmes: (i) zgjerimit të kapaciteteve dhe aftësisë për identifikim proaktiv të rasteve në nevojë për shërbime; (ii) zgjerimit dhe thellimit të partneritetit me çdo institucion, organizatë dhe ofrues shërbimesh dhe (iii) zgjerimit të shërbimeve egzistuese dhe krijimit të shërbimeve të reja për një adresim më të plotë të nevojave të individëve në të gjithë territorin e Bashkisë.

METODOLOGJIA

Në procesin e përgatitjes së Planit Social konsulenti kombëtar i angazhuar nga UNDP punoi ngushtësisht me grupin lokal të drejtuar nga Drejtori i Shërbimit Social në këtë Bashki, duke synuar (i) hartimin e një Plani realist dhe (ii) mbështetjen me kapacitete të ekipit lokal që ai të mund të ndërmarrë në të ardhmen në mënyrë të pavarur proceset e identifikimit të nevojave dhe planifikimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Plani u përgatit në periudhën qershor-nëntor 2023 dhe përgjatë procesit u përdorën disa teknika të kombinuara:

U analizua legjislacioni dhe strategjitë kombëtare. Analiza e legjislacionit kombëtar ndihmoi në tre drejtime kryesore: (i) listimin paraprak të grupeve të mundshme në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror. Paketa ligjore e analizuar ka përkufizuar grupet në nevojë për shërbime. Mbi bazën e tyre u ndërtua më pas kërkimi përmes treguesve socialë dhe administrativë, si dhe konsultimeve të zhvilluara për të identifikuar se cilat janë grupet në nevojë për shërbime, si dhe karakteristikat e tyre; (ii) shporta e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Analiza ndihmoi për të identifikuar tipet e shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe standartet specifike të tyre. Analiza lehtësoi vlerësimin e shërbimeve egzistuese, sikurse dhe planifikimin e shërbimeve që

duhet të ngrihen në territorin e Bashkisë; (iii) strukturat dhe organizimi i Bashkisë në të dy nivelet e saj. Analiza e legjislacionit në këtë këndvështrim është udhërrëfyese për të rishikuar në përputhje me kuadrin ligjor rolet dhe funksionet e Bashkisë në këtë fushë, si dhe burimet njerëzore që duhet të planifikojë për të përmbushur cilësisht këto role e përgjegjësi që i ka dhënë legjislacioni kombëtar.

U konsultuan strategji e plane zhvillimi lokale. Për përgatitjen e Planit Social u konsultuan: (i) Plani vendor për zhvillimin e Komunitetit Rom dhe Egjiptian (2) Plani Lokal për Përfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuara. (3) U analizuan gjithashtu masa e zbatimit të Planit më të fundit Social të Bashkisë me qëllim identifikimin e arritjeve dhe sfidave të ndeshura gjatë zbatimit të tij.

U konsultuan gjithashtu Raporte dhe Udhërrëfyes të hartuara në kuadrin e zbatimit të Programeve të UNDP, specifikisht: “Fondi Social – një realitet mes sfidash lokale” dhe “Kujdesi social në bashki – Mundësitë dhe Sfidat për ngritjen e strukturave¹, si dhe “Udhërrëfyes për bashkitë për planifikimin dhe administrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror²”.

Treguesit socialë dhe administrativë. U identifikuan dhe u mbledhën një numër treguesish socialë dhe administrativë, të cilat lehtësuan identifikimin e grupeve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, karakteristikat e tyre, madhësinë, territorin ku ata jetojnë, si dhe shërbimet egzistuese të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë. Pas përcaktimit të instrumentave nga konsulentit kombëtar ekipi lokal punoi për mbledhjen e të dhënave nga institucionet lokale e rajonale, si dhe ndërveproi me këto institucione për mundësimin e konsultimeve të zhvilluara. Të dhënat u mbledhën në periudhën qershor-shtator 2023. Në procesin e mbledhjes së të dhënave u përfshinë 12 struktura lokale brenda dhe jashtë Bashkisë, si dhe 6 ofruesit e shërbimeve komunitare në territorin e Bashkisë.

Konsultime me aktorë publik, organizata dhe ofrues shërbimesh. U zhvilluan dy tryeza konsultimesh me aktorët publik dhe jopublik lokal e rajonalë me role e përgjegjësi specifike në këndvështrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror (36 pjesëmarrës në tryezën e parë dhe 28 pjesëmarrës në tryezën e dytë). Në procesin e mbledhjes së të dhënave dhe në konsultimet e zhvilluara u përfshinë drejtpërdrejtë: Drejtoria e Shërbimit Social, struktura të Policisë, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Berat, sektori juridik i Bashkisë, Drejtoria e burimeve njerëzore, administratorët shoqëror të çdo njësie administrative, zyra e projekteve në Bashki, Zyra e Punës Berat, përfaqësues të strukturave të shëndetësisë, arsimit, të shërbimeve komunitare (Qendra Lira, Qendra Rezidenciale e PAK, Qendra Multifunkionale, Strehëza e emergjencës, skuadra e terrenit), organizatës joqeveritare “Mjedisi dhe Komuniteti”, Qendrës “Vatra”, QFP “Leta” Berat.

Drafti i Planit Social u konsultua me (1) në format elektronik u dërgua nga Drejtori i Shërbimit Social të Bashkisë në 26 institucionet publike, organizatat dhe ofruesit e shërbimeve

¹ Raporte të hartuara nga HDPC me mbështetjen e UNICEF në kuadrin e projektit të përbashkët të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri “Asnjë të mos mbetet jashtë” mbështetur nga SDC.

² Hartuar nga ESA Consulting në kuadrin e programit “Mbështetje për planifikimin, buxhetimin, financimin dhe ofrimin e shërbimeve shoqërore në nivel vendor”, pjesë e Programit Leave No One Behind, të zbatuar nga agjencitë e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri dhe me mbështetjen financiare të Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim

në nivel Bashkie dhe Qarku; (ii) U organizua një tryezë konsultimi ku morrën pjesë 22 përfaqësues të institucioneve lokale Bashki, shëndetësi, Zyra e Punës, arsim, ofrues shërbimesh. (iii) Plani u Konsultua në një dëgjese publike ku morrën pjesë 19 përfaqësues të grupeve në nevojë (nga të gjitha grupet e identifikuar në nevojë përgjatë hartimit të planit).

Kufizime: Pavarësisht nga përpjekjet për të identifikuar të gjitha grupet në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, vlerësojmë se Plani ka kufizime që rrjedhin nga: (i) Mungesa e të dhënave zyrtare për disa grupe në nevojë, që edhe pse përfaqësuesit e institucioneve i cilësuan si grupe në nevojë për shërbime, nuk rregjistrohen të dhëna për ta. Të tilla janë përdoruesit e drogës (për të cilët u raportuan të dhëna vetëm nga Policia), personat me varësi nga alkooli, si dhe grupi i të moshuarve në nevojë për shërbime, për të cilët në të gjitha konsultimet u vlerësua se madhësia e grupit është më e madhe se sa shifrat e raportuara; (ii) Mungesa e qasjes së strukturave të shërbimit social të Bashkisë për ti identifikuar individët në nevojë drejtpërdrejtë në terren dhe jo thjesht kur ata që kanë nevojë për shërbime të drejtohen vetë tek strukturat vendore. Analiza tregoi se Bashkia nuk ka numrin e mjaftueshëm të personelit që të mund të identifikojë përmes qasjes proaktive individët në nevojë për shërbime. (iii) Pavarësisht përpjekjes për të sjellë të dhëna të disagreguara sipas gjinisë në çdo grup të identifikuar në nevojë, për shumicën e treguesve të mbledhur mungojnë të dhëna të ndara sipas gjinisë. Plani përmes masave konkrete adreson edhe problematikat që sollën kufizimet e lartpërmendura.

LEGJISLACIONI

Plani Social Lokal u hartua duke patur si udhërrëfyes nga njëra anë legjislacionin, strategjitë dhe standartet kombëtare të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe nga ana tjetër prioritetet e përcaktuara nga Bashkia për të adresuar cilësisht nevojat në ndryshim të komunitetit vendor për këto shërbime.

U analizua kuadri strategjik kombëtar duke u fokusuar tek ato strategji kombëtare që kanë në fokus target grupet që kanë të nevojshëm shërbime të kujdesit social. Në mënyrë të veçantë u analizuan: Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2020-2023; Strategjia e Përfshirjes Sociale; Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore; Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve; Strategjia për Punësim dhe Aftësim; si dhe Strategjia për Strehimin Social. Secila nga strategjitë e analizuar është mbajtur në konsideratë në hartimin e këtij Plani, në këndvështrimin e përmbushjes së objektivave të tyre në kushtet lokale, si dhe të përfshirjes në Plan për zbatim të atyre masave dhe veprimeve konkrete që ngarkojnë me përgjegjësi strukturat e njësive të qeverisjes vendore. Padyshim që “Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2022-2023”, me tre prioritetet strategjike që përcakton, mban peshën kryesore në konceptimin dhe drejtimin e përgatitjes së këtij Plani. Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë, përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara dhe zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social, prioritetet strategjike të Qeverisë Shqiptare, përbëjnë edhe shtyllat thelbësore mbi të cilat ngrihet ky plan.

Analiza e legjislacionit kombëtar³ ishte thelbësore për të mundësuar analizën e situatës në kushtet lokale në katër drejtime kryesore:

³ Në shtojcë “Referenca” gjeni të plotë Strategjitë, Legjislacionin dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave të analizuar në funksion të përgatitjes së këtij Plani Social.

- (1) **Listimin paraprak të grupeve të mundshme në nevojë** për shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë: Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" në nenin 6 të tij ka përcaktuar qartësisht përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, duke lehtësuar kështu listimin paraprak të grupeve të mundshme në nevojë për shërbime. Metodat e ndjekura më pas gjatë procesit të përgatitjes së këtij Plani mundësuan konkretizimin për këtë Bashki të çdo grupi në nevojë për shërbime, karakteristikat dhe madhësinë e tyre, si dhe shtrirjen e tyre në territor.
- (2) **Analiza e shërbimeve egzistuese dhe planifikimi i shërbimeve të reja:** Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM nr. 518, date 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar" kanë përcaktuar qartësisht të gjitha format e shërbimeve të kujdesit shoqëror që adresojnë nevojat e grupeve të ndryshme në nevojë për shërbime. Ndërkohë për çdo formë shërbimi është formuluar e miratuar standarti kombëtar i shërbimit, prandaj analiza e Vendimeve të Këshillit të Ministrave apo Udhëzimeve të Ministrit përgjegjës për shërbimet shoqërore me të cilat janë miratuar këto standarte ishte gjithashtu e rëndësishme në funksion të përgatitjes së planit, pasi përmes tyre : (i) u identifikuan tipet e shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe standardet specifike të tyre; (ii) u mundësua vlerësimi i shërbimeve egzistuese, sikurse dhe u lehtësua procesi i planifikimit të shërbimeve që duhet të ngrihen në territorin e Bashkisë;
- (3) **Analiza e strukturave, organizimit të Bashkisë në të dy nivelet e saj, si dhe kapacitetet financiare.** Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", si dhe Ligji 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" kanë përcaktuar qartësisht funksionet e Bashkive në fushën e shërbimeve sociale. Për ti përmbushur funksionet e tyre ligjore Bashkitë duhet të kenë burimet financiare dhe njerëzore të nevojshme. Analiza e ligjeve, "Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Ligji 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", Ligji Nr. 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", Ligji Nr. 93/2014 "Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara", Ligj Nr.18/2017 "Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës", Ligji 22/2018 "Për strehimin social", Ligji 47/2018 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", Ligji "Për barazinë gjinore, ndihmoi procesin e analizës dhe planifikimit në dy komponentë të rëndësishëm: (i) **organizimi i Bashkisë dhe burimet njerëzore.** Dy janë strukturat që Bashkia duhet të ndërtojë me qëllim funksionimin e sistemit komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Struktura përgjegjëse për mbrojtjen dhe kujdesin social në Bashki, e cila në thelb duhet të planifikojë, ndërtojë e të garantojë funksionimin e sistemit komunitar të shërbimeve shoqërore. Përveç funksioneve të drejtpërdrejta të mbrojtjes sociale (pagesat në para për familjet me ndihmë ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuara) dhe planifikimit e ngritjes së shërbimeve shoqërore, kjo strukturë duhet të përmbushi funksione që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve (përmes Njësisë së Mbrojtjes së fëmijës), të masave kundër dhunës me bazë gjinore (përmes Koordinatorit vendor për masa kundër dhunës në familje), adresimin e çështjeve gjinore (koordinatori gjinor)

dhe përfshirjes sociale (nëpunësi për aksesueshmërinë). Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit janë struktura që në përputhje me ligjin 121/2016 “Për shërbimet e Kujdesit shoqëror” duhet të përmbushin funksionet e identifikimit, menaxhimit dhe referimit në shërbime të individëve në nevojë për shërbime. Kjo strukturë, sipas nenin 36 të këtij ligji, duhet të ngrihet në nivelin e njësisë administrative dhe duhet të ketë në përbërje administratorin shoqëror (në zbatim të ligjit për asistencën sociale), punonjësin social (një punonjës social për 6.000 deri në 10.000 banorë) dhe punonjësin e mbrojtjes së fëmijës (sipas ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës për çdo 3.000 fëmijë duhet të ketë një PMF). (ii) **kapacitetet financiare**. Ligji 121/2016 “Për shërbimet e Kujdesit shoqëror” dhe pika 2 e VKM nr. 111, datë 23.2.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social”, përcaktojnë se çdo Bashki ngre Fondin Social, i cili krijohet me burime financiare, nga: fondet e kushtëzuara që akordohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale; fondet nga buxhetet e njësisë të vetëqeverisjes vendore, të parashikuara për shërbimet shoqërore; të ardhurat nga organizatat jofitimprurëse, individët e bizneset, si dhe donatorë të huaj e lokalë; tarifat për shërbimet për përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Në tërësi analiza e legjisllacionit për të dykomponentet: burime njerëzore e financiare të Bashkisë mundësoi identifikimin e kapaciteteve egzistuese të Bashkisë duke mbajtur referencë parashikimet kombëtare e për rrjedhojë udhëhoqi planifikimin e masave që duhet të përfshihen në plan për të adresuar problematikat egzistuese.

- (4) **Analiza e ndërveprimit multisektorial dhe ndërinstitutional.** Bashkia me strukturat e saj përgjegjëse nuk është i vetmi institucion që ka role e përgjegjësi specifike që rrjedhin nga legjisllacioni kombëtar për të adresuar nevojat e grupeve vulnerabël në territorin e saj. Një numër institucioneve publike në nivel lokal e rajonal kanë përgjegjësi specifike për grupe specifike. Ndërveprimi i masave dhe punës së të gjitha këtyre institucioneve është thelbësor për të adresuar cilësisht nevojat e individëve në nevojë për shërbime shoqërore. Detyrimin për ndërveprim e gjejmë jo vetëm në kuadrin ligjor, por veçanërisht në aktet nënligjore që kanë përcaktuar qartësisht se çfarë masash/ndërrhyrjesh merren nga çdo institucion në situata specifike që synojnë mbrojtjen dhe përkujdesin ndaj individëve të ndryshëm në situatë të vështirë. Të tilla janë vendimet e Këshillit të Ministrave që kanë përcaktuar rregullat e bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave këshillimorë e koordinues institucionalë, strukturave për: fuqizimin ekonomik të individëve përfitues të ndihmës ekonomike, mbrojtjen e fëmijëve, masat kundër dhunës në familje, për viktimat e trafikimit, të moshuarit etj. Analiza e këtyre akteve nënligjore mundësoi jo vetëm analizën e gjendjes egzistuese të reagimit ndërinstitutional, por edhe planifikimin e masave që duheshin përfshirë në këtë plan me qëllim adresimin e problematikave të identifikuara.

1. ANALIZA E GRUPEVE NË NEVOJË DHE SHËRBIMEVE EGZISTUESE

1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM


Të paktën 5,143 individë u identifikuan, nga të dhënat e mbledhura dhe analizuan, që kanë të nevojshme të paktën një formë shërbimi mbrojtje apo përkujdesi social. Duke ju referuar numrit të përgjithshëm të popullsisë të rregjistruar në gjendjen civile në bashkinë Berat rezulton se është 5,2% e popullsisë që ka nevojë për mbrojtje apo përkujdesje. Duke mbajtur në konsideratë faktin që migracioni dhe emigracioni ka larguar një përqindje të popullsisë nga territori i kësaj Bashkia konkludojmë që pesha që zenë individët në nevojë tek totali i popullsisë realisht banues në Bashki është më i madh.

Njesia administrative	Invalid pune	PAK shikimi	Para-tetraplegjik	PAK fizik mendor	Individ NE	Dhuna ne familje	Femije (pa NE dhe PAK)	Te moshuar	Perdorues alkooli	Perdorues droge	Divorce	TOTALI
Berat	1179	223	65	622	540	72	37	40	6	72	100	2956
Velabisht	145	62	9	140	179	11	1	7				554
Roshnik	51	24	1	59	198	4	1	4				342
Sinje	52	23	7	90	502	1		14			5	694
Otlak	124	36	5	162	232	2		7			29	597
Totali	1551	368	87	1073	1651	90	39	72	6	72	134	5,143

Peshën kryesore në totalin e identifikuar e kanë individët pjesë e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuara që përfitojnë nga programi kombëtar i mbrojtjes sociale, kjo pasi analiza tregoi se ende mungojnë mekanizmat e duhur për identifikimin në territor të çdo individi në nevojë për shërbime.

Grafiku 1 paraqet shpërndarjen e individëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje sipas Njësisë Administrative të Bashkisë Berat. Njësia administrative Berat ka përqindjen më të lartë të individëve të identifikuar në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje (57%), Sinja, Otlaku dhe Velabishti kanë respektivisht 13%, 12% dhe 11% të individëve në nevojë dhe përqindjen më të ulët e ka Roshniku (7%).

G.1. INDIVIDE NE NEVOJE SIPAS NJESIVE ADMINISTRATIVE



Gjithsesi në raport me numrin e popullsisë për njësinë administrative situata paraqitet ndryshe: Në Sinjë 13.4% e popullsisë është në nevojë; Në Roshnik 9,6% e popullsisë së saj; Në Berat 4,7% e popullsisë; Në Velabisht 4,6% e popullsisë; Në Otlak 3,8% e popullsisë;

Treguesit socialë e administrativë, tryezat dhe konsultimet e zhvilluara që morën këndvështrimin e institucioneve, ofruesve publikë dhe jopublikë të shërbimeve të kujdesit shoqëror, identifikuan këto grupe kryesore në nevojë për shërbime sociale: (i) Familje pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme, (ii) persona me aftësi të kufizuara, (iii) viktimat të dhunës në familje, (iv) fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje, (v) familje rome dhe egjiptiane, (vi) të moshuar në nevojë për shërbime, (vii) përdorues të drogës e alkoolit dhe (viii) familje që kanë përjetuar divorc.

Madhësia e çdo grupi dhe shtrirja në territor është analizuar gjerësisht në seksionet vijuese. Pavarësisht përpjekjes për të qenë sa më shterues në identifikimin e grupeve dhe madhësisë së tyre, mungesa e të dhënave të mbledhura dhe të regjistruara sistematikisht për rastet e menaxhuara apo rastet që kanë kërkuar shërbime, edhe atëherë kur shërbimet mungojnë, lë vend për pasaktësi. Aktualisht, në Bashkinë e Beratit, ka nisur ngritja e Rregjistrimit Kombëtar të Shërbimeve Shoqërore, i cili do të mundësojë regjistrimin sistematik të të dhënave të individëve në nevojë për shërbime.

Analiza për secilin grup në nevojë të identifikuar pasqyron shërbimet egzistuese dhe nivelin e përfshirjes së secilit grup në këto shërbime. Analiza tregoi se Bashkia ka arritur të ngriejë fonde për financimin e disa shërbimeve sociale në territorin e saj duke siguruar mbështetjen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, UNDP që përmes programeve të saj ka financuar ngritjen e një pjese të rëndësishme të shërbimeve sociale që vijnë të funksionojnë. Gjithashtu partneriteti i Bashkisë Berat me ofrues jopublik shërbimesh ka mundësuar funksionimin e disa shërbimeve sociale. Analiza tregoi se zgjerimi i shërbimeve egzistuese dhe ngritja e shërbimeve të reja sociale është e domosdoshme për të adresuar nevojat e grupeve të identifikuara në territorin e Bashkisë Berat.

2. INDIVIDË NË NEVOJË PËR SHËRBIME DHE SHËRBIMET EGZISTUESE

2.1. Në familje pa të ardhura/me të ardhura të pamjaftueshme⁴

✓ *Madhësia e grupit dhe shtrirja në territor*

Sipas të dhënave të Rregjistrimit Kombëtar të Ndihmës Ekonomike në qershor 2023 në këtë Bashki aplikuan për të përfituar ndihmë ekonomike 622 familje dhe 483 prej tyre përfituan këtë ndihmë. Përqindja e pranimit në skemën e ndihmës ekonomike në këtë muaj është 77,6%. Nëse krahasojmë këto të dhëna me Dhjetor 2021 vëmë re se ka një rënie si të numrit të aplikimeve, ashtu edhe të përqindjes së pranimit të familjeve në këtë skemë. Në dhjetor 2021 aplikuan për ndihmë ekonomike 648 familje, pra 4,1% më shumë se në qershor 2023 dhe përfituan ndihmë ekonomike 552 familje, pra 12,5% më shumë familje se në qershor 2023. Përqindja e pranimit në skemën e ndihmës ekonomike në dhjetor 2021 ishte 85% ndërkohë që në qershor 2023 është 77,6%. Rënia lidhet kryesisht me lëvizjet e popullsisë dhe shumë pak vjen nga efektet e punësimit.

Rënia në skemë duket se ka prekur më shumë zonën rurale të Bashkisë. Në zonën urbane numri i familjeve përfituese ka rënë me 5%, ndërsa në zonën rurale rënia është 18%. Sërisht kjo lidhet me lëvizjet e popullsisë.


Në të dy periudhat e krahasuara numri më i lartë i përfituesve është në zonën rurale të Bashkisë. Siç shihet nga grafiku në qershor 2023 nga 483 familje përfituese nga skema kombëtare 45% banojnë në territorin e tre Rajoneve të Bashkisë Berat dhe 55% në katër njësitë administrative. Procesi i verifikimit të aplikimeve për NE është më i lehtë për aplikuesit në zonën urbane të bashkisë. Kjo pasi, një pjesë e informacioneve për zonën rurale janë ende të paplota apo të parregjistruara, të tilla janë të dhënat lidhur me asetet dhe pronën. Në këto kushte, në këto zona, roli i administratorit shoqëror në procesin e vlerësimit socio-ekonomik merr një rendësi parësore, por duke e bërë procesin më subjektiv.

Përmes fondit 6% Bashkia Berat ka trajtuar me ndihmë ekonomike në të njëjtën periudhë (qershor 2023) edhe 76 familje, 89% e të cilave i përkasin tre rajoneve të Beratit. Për rrjedhojë në qershor 2023 janë trajtuar me ndihmë ekonomike 559 familje në këtë Bashki. Trajtimi përmes fondit 6% dhe nga të ardhurat e Bashkisë kryesisht e familjeve në zonën urbane lidhet me përpjekjen e Bashkisë për të mbështetur familje që edhe pse kanë të ardhura të pamjaftueshme nuk mbështeten nga sistemi kombëtar.

Kundrejt numrit të përgjithshëm të familjeve në Bashkinë Berat (34,757 familje), 1,6% e tyre përfitojnë ndihmën ekonomike. Përqindja që zenë familjet përfituese të ndihmës ekonomike ndaj numrit total të familjeve është e ndryshme në njësi të ndryshme të Bashkisë Berat (shih grafikun 2).


⁴ Individë që janë në pamundësi për të plotësuar nevojat e tyre të jetesës, vetë ose me ndihmën e anëtarëve të familjes, për shkak të kushteve personale dhe sociale.

G.2. FAMILJE N.EK/TOTALIT FAMILJE



Njësitë administrative Sinjë (7,2% e familjeve me NE) dhe Roshnik (3,6% e familjeve me NE) kanë nivelin më të lartë të varfërisë krahasuar mesatares në nivel Bashkie.

G.3 FAMILJE ME NDIHME EKONOMIKE



Shpërndarja në territor e 559 familjeve përfituese të ndihmës ekonomike pasqyrohet në grafikun 3. Nga njësitë administrative në zonën rurale të Bashkisë përqindjen më të lartë të familjeve përfituese e kanë Sinja dhe Otlaku.


✓ Karakteristikat e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike

Janë 1,651 individë në familjet përfituese të ndihmës ekonomike, nga të cilët 49,6% janë femra dhe 50,4% janë meshkuj. Duke ju referuar numrit të përgjithshëm të popullsisë në këtë Bashki (48,9% të popullsisë femra dhe 51,1% të saj meshkuj) mund të themi se ndër përfituesit e ndihmës ekonomike ka një përqindje më të lartë të femrave krahasuar me përqindjen që ato zënë në totalin e popullsisë në Bashki.

Mes 1,651 individëve në familjet përfituese të ndihmës ekonomike 629 janë fëmijë të grupmoshës 0-18 vjeç (38% e përfituesve), 971 janë individë të grupmoshës 19-64 vjeç (59% e përfituesve) dhe 51 janë individë të grupmoshës mbi 65 vjeç (3% e përfituesve).

Numri mesatar i pjesëtarëve në familjet përfituese të ndihmës ekonomike është 3,4 anëtarë. Ndërkohë në numri mesatar i pjesëtarëve të familjeve në Bashkinë Berat sipas të dhënave të gjendjes civile është 2.9 anëtarë.

G.4 KARAKTERISTIKAT E FAMILJEVE ME NDIHME EKONOMIKE



Janë 82 gra kryefamiljare (10% e totalit të grave përfituese) përfituese të skemës së ndihmës ekonomike. 52,4% e tyre banon në zonën urbane të Bashkisë.

Janë 24 familje që kanë të paktën një pjesëtar me aftësi të kufizuara. Vetëm 13% e tyre banon në zonën urbane të Bashkisë, 87% banon në zonën rurale të saj. Këto familje përveç nevojës për mbështetje me shërbime për personin me aftësi të kufizuara përballen edhe me sfidën e varfërisë/pamjaftueshmërisë ekonomike.

Janë 48 familje rome/egjiptiane që përfitojnë ndihmën ekonomike. Në përqindje më të madhe ato banojnë në zonën urbane (73%) dhe në Otllak. Administratorët shoqëror theksojnë se ka ende familje rome/egjiptiane që nuk trajtohen nga sistemi kombëtar edhe pse aplikojnë kryesisht për shkak të mos rregjistrimit në Zyrën e Punës. Megjithatë Bashkia i konsideron si grup prioritar dhe i trajton nga të ardhurat e saj.

20 familje kanë të paktën një të moshuar në moshë pensjoni dhe 10% e tyre banon në zonën urbane, 90% në pjesën rurale të Bashkisë.

✓ Shërbimet ekzistuese për individët e familjeve përfituese të NE5

Fuqizimi ekonomik përmes punësimit

Sipas të dhënave të Zyrës së Punës janë 1,100 individë, banorë të Bashkisë Berat, që në vitin 2022 rezultojnë të regjistruar në Zyrën e Punës. Karakteristikat kryesore të punëkërkuesve të papunë janë:

86% e punëkërkuesve jetojnë në territorin e qytetit Berat, ndërsa 14% në njësitë e tjera administrative. Njësitë administrative Otllak dhe Velabisht kanë fasonë në afërsi dhe kanë mundësi punësimi. Banorët e Roshnikut dhe Sinjës e kanë të pamundur të vijnë në qytet për të punuar shkak të distancës dhe koston e transportit.

Ndërkohë, 51,7% e punëkërkuesve kanë moshë mbi 40 vjeç. Në fakt projektet për nxitjen e punësimit kanë target grupmoshat deri në 35 vjeç.

5 Në fokus janë shërbimet për grupmoshën 18-64 vjeç, pasi shërbimet për fëmijët, të moshuarit dhe komunitetin rom dhe egjiptian do të analizohen tek seksionet që lidhen me këto grupe specifike.

35,4% nuk kanë arsim ose kanë arsim fillor dhe 9 vjeçar. 17% ka arsim të mesëm të përgjithshëm. 47,6% kanë arsim profesional apo kanë kryer studimet e larta.

50,5% e punëkërkesve të regjistruar janë femra, ndërkohë që 9% e tyre janë kryefamiljare; 18% e punëkërkesve janë romë dhe egjiptianë (200 individë).

Ka një nivel të ulët të regjistrimit si punëkërkes të papunë të personave me aftësi të kufizuara. Vetëm 0.9% e personave me aftësi të kufizuara të grupmoshës 18-64 vjeç janë të regjistruar si punëkërkes (10 individë).

Aktualisht, figurojnë 300 punëkërkes të papunë njëkohësisht përfitues të NE (27,3% e totalit të punëkërkesve). Siç jepet në tabelën 2 ka një regjistrim pothuajse të plotë (93%) në zyrën e Punës të individëve në moshë pune që banojnë në qytetin Berat. Nga njësitë administrative Velabisht dhe Otllak ka një nivel shumë të ulët regjistrimi të individëve përfitues të ndihmës ekonomike, ndërkohë që ka nivel të lartë regjistrimi nga këto njësi administrative të individëve të tjerë jo përfitues të ndihmës ekonomike. Administratorët shoqërorë theksojnë se përgjithësisht është krijuar një lloj varësie e familjeve përfituese nga skema e ndihmës ekonomike dhe për pasojë shfaqin rezistencë në pranimin e ofertave të punës.

Tabela 2: Të dhëna mbi punëkërkes të papunë (Zyra e Punës)

Njësia administrative	Individë N.EK në moshë pune	Individë N.EK të regjistruar në Z.Punës	Totali i punëkërkes Z.Punës
Berat	299	279	886
Roshnik	130	0	
Velabisht	109	7	86
Sinje	293	4	18
Otllak	140	10	110
Totali	971	300	1100

Në të njëjtën periudhë (vitit 2022) janë punësuar nga Zyra e Punës 50 punëkërkes të regjistruar nga familjet përfituese të ndihmës ekonomike, pra 16% e totalit të regjistruar. 75% e të punësuarve janë femra dhe 25% meshkuj. 24% e të punësuarve nga ky grup janë gra kryefamiljare.

Punësimi i individëve banues në territorin e qytetit Berat ka rezultuar më i suksesshëm pasi 84% e të punësuarve nga ky grup i përkasin këtij territori.

72% e të punësuarve i përkasin komunitetit rom/egjiptian dhe 8% e të punësuarve janë persona me aftësi të kufizuara.

Ky nivel punësimi i individëve pjesë e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike është rezultat i partneritetit mes Drejtorisë së Shërbimit Social të Bashkisë dhe Zyrës së Punës Berat. Administratorët shoqërorë sistematikisht përgatisin skedat e individëve në moshë pune të këtyre familje që kanë kapacitetin ëpr të punuar dhe ja përcjellin zyrës së Punës.


Kjo e fundit zbaton tre programe për punësimin e tyre : (i) Pune publike ne komunitet; (ii) Vetpunësimi dhe (iii) Formimin ne pune dhe praktika profesionale.

Strehimi social

Bashkia Berat me programet e saj të strehimit priorizon grupet më të pafavorizuara, si familjet me NE, gratë kryefamiljare, komunitetin egjiptian dhe rom, viktimat e dhunës në familje, personat me aftësi të kufizuara, duke siguruar që ata të kenë akses në strehim të përballueshëm. Bashkia zbaton tre programe të strehimit social, specifikisht: (i) Banesa sociale (aktualisht janë 55 familje përfituese), (ii) bonus qeraje (45 familje përfituese) dhe (iii) përmirësim i banesave egzistuese (63 familje përfituese)

Gjatë vitit 2022 sipas të dhënave të Drejtorisë së Strehimit në këtë Bashki numri i aplikuesve për strehim social ishte 117 familje, nga të cilat 16 ishin nga familje përfituese të ndihmës ekonomike. Përfitues gjatë vitit 2023 janë 160 familje nga të cilat 19 janë familje që përfitojnë ndihmë ekonomike.

Siç shihet në grafikun 5, një njësinë administrative Roshnik të gjitha familjet përfituese nga programi janë familje me ndihmë ekonomike. Në Otlak 14% e përfituesve janë familje me ndihmë ekonomike, në Sinje 30% e familjeve përfituese janë me ndihmë ekonomike, në Berat 5%, ndërsa në Velabisht asnjë familje me ndihmë ekonomike nuk përfiton nga programi i strehimit social.



2.2. Persona me aftësi të kufizuara⁶



✓ Madhësia e grupit dhe shtrirja në territor

Sipas të dhënave të Bashkisë Berat në territorin e kësaj Bashkie sipas vlerësimeve të Komisionit Bio-Psiko Social janë 1,528 persona me aftësi të kufizuara të të gjitha grupmoshave. Përmes skemës së mbrojtjes sociale trajtohen gjithashtu me pagesë edhe 1,551 invalidë pune. Në total në nivel Bashkie janë 3,079 individë që kanë të paktën një formë të aftësisë së kufizuar dhe që, përveç pagesës që përfitojnë nga skema e mbrojtjes sociale, kanë


6. Bashkia ka hartuar tashmë Planin e Përfshirjes Sociale për Personat me Aftësi të Kufizuara që do të zbatohet në të njëjtën periudhë kohore me atë të këtij Plani Social, prandaj prioritetet mbi këtë grup në nevojë për shërbime dhe niveli i përfshirjes së tyre në shërbime mbajnë në konsideratë parashikimet e atij Plani.

të nevojshme shërbime sociale e shëndetësore sipas formës së aftësisë së kufizuar që përjetojnë. Referuar numrit të përgjithshëm të popullsisë në këtë Bashki mund të themi se në këtë Bashki 3,08% e popullsisë ka të paktën një formë të aftësisë së kufizuar.

Në grafikun 6 jepet shpërndarja në territor i personave me aftësi të kufizuara. Siç shihet 68% e tyre jetojnë në tre rajonet e qytetit të Beratit dhe 32% në territorin e njësive administrative Otllak (11%), Velabisht (11%), Sinjë (6%) dhe Roshnik (4%). Megjithatë nëse i referohemi vetëm skemës së aftësisë së kufizuar të vlerësuar nga Komisionet Bio-Psikosociale të Shërbimit Social Shtetëror 61% e tyre jetojnë në tre rajonet e qytetit të Beratit dhe 39% në territorin e njësive administrative Otllak (10%), Velabisht (17%), Sinjë (6%) dhe Roshnik (6%).




Në grupin e 1,528 personave me aftësi të kufizuara përfshihen 368 individë me probleme shikimi, 87 persona paratetraplegjikë dhe 1,073 persona me probleme të shëndetit fizik ose mendor. 369 persona me aftësi të kufizuara (12,6% e totalit të PAK) kanë një formë të rëndë të aftësisë së kufizuar e për rrjedhojë kanë të nevojshme asistencën e vazhdueshme të një personi që i mbështet në jetesën e përditëshme.



33,7% e personave me aftësi të kufizuara janë fëmijë të grupmoshës 0-18 vjeç. Specifikisht: 44% e tyre i përkasin grupmoshës 0-6 vjeç; 38% i përkasin grupmoshës 7-15 vjeç dhe 18% janë të grupmoshës 16-18 vjeç.

G.9 FEMIJE ME AFTESI TE KUFIZUARA



Siç shihet në grafik 82% e fëmijëve me aftësi të kufizuara jetojnë në territorin e njësisë administrative të qytetit të Beratit.

✓ **Shërbimet për personat me aftësi të kufizuara**

Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave të personave me aftësi të kufizuara

Bashkia Berat menaxhon vetëm rastet kur individit PAK është paraqitur për të marrë shërbim. Aktualisht, nuk ka një sistem të mirëfilltë referimi për këtë kategori dhe veçanërisht për ndërhyrjen e herëshme.

Vlerësimi bio-psiko-social i cili po zbatohet tashmë edhe në territorin e Bashkisë Berat bën të mundur përcaktimin e shkallës së prekjes së aftësisë për të realizuar veprimtaritë bazë e ato të jetës së përditshme (që përfshin edhe aftësinë për punë) të grupuar në nivelet e lehtë (5-24%), e moderuar (25-49%), e rëndë (50-95%) dhe e thellë apo e plotë (96-100%). Kjo lejon përcaktimin objektiv të nivelit të aftësisë së kufizuar, si edhe nevojat për shërbime të tjera si ndihmësi personal, paketa higjeno-sanitare, përkthyesi i gjuhës së shenjave, mjetet ndihmëse për lëvizje, etj. Pjesë e vlerësimit janë intervistat nëpërmjet të cilave komisioni bën vlerësimin për të krijuar profili bio-psiko-social i përfutuesit të aftësisë së kufizuar e më pas bën rekomandimet përkatëse në lidhje me përfutimet në pagesa dhe shërbimet shëndetësore, psiko-sociale, të arsimit, të formimit profesional dhe punësimit, strukturën familjare të personave me aftësi të kufizuara etj. Vendimi i Komisionit i kalon administratorit shoqëror jo vetëm për të kryer pagesën mujore, por edhe për ta referuar individin tek shërbimet që listohen në formën e vlerësimit. Rastet kryesisht referohen në Zyrën e Punës dhe në Zyrën Vendore Arsimore.

Bashkëpunimi mes qendrave shëndetësore dhe bashkisë në lidhje me personat me aftësi të kufizuara është thelbësor, si për identifikimin dhe ndërhyrjen e hershme, vlerësimin dhe adresimin në kohë, por edhe sigurimin e një shërbimi ndërdisiplinar dhe gjithëpërfshirës.

Shërbimi shëndetësor

Plani i Përfshirjes Sociale për personat me aftësi të kufizuara në bashkinë Berat ka prezantuar gjerësisht situatën⁷ me shërbimet shëndetësore në këtë Bashki. Për qëllime të Planit social theksojmë se:

Kujdesi shëndetësor parësor mundësohet nga 35 mjekë familje që i përgjigjen nevojave të një populatë prej 99,735 banorësh (1 mjek familje/2,879 banorë) dhe 7 qendra shëndetësore (3 urbane dhe 4 rurale). Qendrat shëndetësore kanë përgjegjësi për ndërhyrjen e hershme të

⁷ Shih Planin Lokal për Përfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuara, "Vlerësimi i gjendjes, shërbimet shëndetësore" faqe 17

aftësisë së kufizuar dhe paraqitet e nevojshme bashkërendimi i punës për një ndërhyrje të vazhduar, holistike dhe të koordinuar me qëllim, parandalimin, lehtësimin dhe menaxhimin në kohë dhe me cilësi për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Berat ka një sektor të veçantë për persona me probleme të shëndetit mendor, që ofron shërbim diagnostikues, rehabilitues, këshillim psiko-social, vizita tek mjeku neurolog dhe psikiatër, si dhe orientim/këshillim dhe lehtësim për plotësim dokumentacioni për çdo klient me shëndet mendor për grup moshat mbi 18 vjeç. Kjo njësi punon në partneritet me mjekët e familjes dhe raporton një tendencë rritëse të rasteve me probleme të shëndetit mendor. Vetëm në periudhën janar-tetor 2023 ajo ka trajtuar 120 raste të reja.

Bashkia ndërvepron me punishten e ngritur nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Vorë për ofrim shërbimi për karrige me rrota dhe mjete të tjera ndihmëse për persona me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për to.

Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim

Mungojnë të dhëna për numrin e fëmijëve të përfshirë në shkolla në këtë vit arsimor. Raportohet që vetëm një pjesë e shkollave janë tërësisht të aksesueshme për fëmijët me aftësi të kufizuara (10 shkolla).

Shërbimi i mësuesit ndihmës ofrohet për çdo fëmijë të vlerësuar në nevojë për këtë shërbim nga komisioni multidisiplinar i Zyrës Vendore Arsimore.

Bashkia Berat nuk ka të dhëna të plota apo të detajuara periodike, të të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla, sipas moshës, gjinisë, diagnozës, nivelit të dëmtimit etj. Këto të dhëna do të shërbenin për një gjurmim, adresim, mbulim e monitorim të koordinuar të çdo fëmije me aftësi të kufizuar. Informacioni që disponon Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës në bashki në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara në shkolla lidhet me rastet e fëmijëve në proces menaxhimi të rastit nga punonjësi mbrojtjes së fëmijëve.

Shërbimi i punësimit për PAK

Sipas statistikave zyrtare, numri i personave me aftësi të kufizuar të regjistruar në zyrat e punësimit, si punëkërkues të papunë, në vitin 2022 ishte 10 persona. Në vitin 2023 katër persona me aftësi të kufizuara janë punësuar nga kjo zyrë dhe 2 persona janë punësuar nga Bashkia Berat. Siç shihet ka nivel të ulët rregjistrimi për punë si dhe për punësim të tyre.

Shërbimi i strehimit social për PAK

Grupi i personave me aftësi të kufizuar konsiderohet si grup prioritar për trajtimin me strehim në përputhje me ligjin për strehimin social dhe çdo rast që aplikon trajtohet me prioritet nga Bashkia Berat.

Shërbimet zhvilluese dhe rehabilituese sociale

Qendra “Lira”

Ofron shërbim rezidencial (apartamente të mbrojtura) për 20 persona me aftësi të kufizuara në Bashkinë Berat, si dhe shërbim ditor për 49 fëmijë me aftësi të kufizuara. Në këtë qëndër ofrohen nga specialistë shërbime të tilla si; lokopedi, fizioterapi, terapi individuale zhvillimi.

Përfitues të shërbimeve në Qendrën “Lira” janë 69 persona me aftësi të kufizuara, prej të cilëve 49 fëmijë. Përfituesit e shërbimeve të qendrës janë persona me aftësi të kufizuara të cilët i përkasin llojeve të ndryshme të aftësisë së kufizuar, por kryesisht janë persona me aftësi të kufizuara të zhvillimit mendor, fizik dhe fëmijë me çrregullime të spektrit autik.

Është i nevojshëm trajnimi i vazhdueshëm i stafit në terapi konjitive, gjuhësor dhe motorik. Është i nevojshëm gjithashtu mbështetje financiare për bazë materiale, krijimin e ambjenteve të stimulimit bazal, rritje e numrit të stafit, krijimi i ambjenteve specifike për menaxhimin e krizave.

Gjithashtu mungojnë hapësira për strehimin e fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara që janë pa kujdestar ose të braktisur.

Qendra “Unë jam si ju”


Eshtë një qendër rezidenciale e cila për të gjithë aktivitetin që kryen financohet nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe nga buxheti i Bashkisë Berat për mirëmbajtjen dhe investimet në infrastrukturën e qendrës. Përfitues të shërbimeve të kësaj qendre janë 27 persona me aftësi të kufizuara, prej të cilëve 12 femra. Përfituesit i përkasin grup-moshave të ndryshme: 2 përfitues të grupmoshës nga 14-18 vjeç; 5 përfitues të grupmoshës 18-25 vjeç dhe 20 përfitues, persona me aftësi të kufizuara të grupmoshës mbi 25 vjeç.

Qendra ofron për të gjithë përfituesit shërbim rezidencial. Stafi i qendrës kujdeset për personat me aftësi të kufizuara 24 orë, duke u mundësuar atyre kujdes për ushqimin, shërbimet shëndetësore, infermierike, si dhe dhënien e medikamenteve. Gjithashtu qendra ofron terapi zhvillimi, fizioterapi.

2.3. Viktima të dhunës në familje


✓ *Madhësia, karakteristikat e grupit dhe shtrirja në territor*

Për të vlerësuar madhësinë e këtij grupi, si dhe shtrirjen e tij në territorin e Bashkisë u kërkuar të dhëna nga tre burime kryesore: (i) koordinatori vendor për masa kundër dhunës në familje, (ii) policia dhe (iii) shëndetësia.



Siç shihet në grafikun 10, strukturat e shëndetësisë nuk kanë raportuar raste dhune edhe pse sipas policisë në katër raste dhuna ka shkaktuar plagosjen e viktimës. Mjekët janë të trajnuar për procedurat standarte të veprimit në rastet e dhunës. Strukturat e policisë kanë raportuar 90 raste dhune, pra 58% më shumë raste dhune se sa strukturat e Bashkisë. Ndryshimi më i madh qëndron në shifrat e dhunës në territorin e qytetit Berat me 31 raste më shumë të raportuara nga strukturat e policisë.

Sipas të dhënave të koordinatorit vendor për masa kundër dhunës në familje gjatë vitit 2022 u identifikuan dhe menaxhuan 52 raste të dhunës në familje. Siç shihet në grafikun 11, 79% e



rasteve i përket territorit të qytetit Berat, Velabishtit 13% e rasteve, Roshnik 6% e rasteve, Otlak 2% dhe në Sinjë asnjë rast dhune. Numri më i ulët i denoncimit të dhunës në zonën rurale lidhet me dy faktorë: (i) ka një rënie të numrit të popullsisë që jeton fizikisht në këtë zonë dhe (ii) stigma që egziston dhe që e frenon viktimën për ta denoncuar dhunën që përjeton.

Gjithashtu raportohet se 73% e rasteve viktime është femër dhe në 27% është mashkull. Kjo e fundit janë kryesisht raste dhunë brenda gjinisë.

Trendi i masave të mbrojtjes ka ardhur duke rënë. Në vitin 2023 ka një numër më të vogël të urdhrave të mbrojtjes pasi në shumë raste viktime tërheq denoncimin.


✓ *Mekanizmi i referimit*

Bashkia ka ngritur mekanizmin lokal të koordinuar për identifikimin dhe adresimin e nevojave të viktimave të dhunës në familje. Institucionet e përfshira në këtë mekanizëm bashkëpunojnë dhe ndërveprojnë si për informimin e komunitetit për ta parandaluar dhunën ashtu edhe gjatë menaxhimit të rasteve të dhunës. Megjithatë ndryshimi i shpeshtë I përfaqësuesve të institucioneve në takimet e grupeve teknike ndërsektorale vështirëson punën e strukturës përgjegjëse të Bashkisë gjatë menaxhimit të rasteve. Fushatat e ndërgjegjësimit ndërmerren kryesisht gjatë muajit kundër dhunës.

✓ *Shërbimet për viktimat e dhunës në familje*

Në grafikun 12 jepen shërbimet që kanë përfituar viktimat e dhunës në familje, sipas raportimit të Koordinatorit Vendor për masa kundër dhunës në Bashkinë Berat

G.12.SHËRBIME OFRUAR VIKTIMAVE TE DHUNES/ VITI 2022



Bazuar në sa më lart paketa e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje në Bashkinë Berat përfshin:

Ndihmë Ekonomike;

Strehim Social

Punësim

Këshillim psikologjik dhe ligjor;

Shërbime emergjence

Shërbim për fëmijët e viktimave të dhunës

Shërbim i emergjencës

Strehëza e emergjencës ofron shërbim 72 orë për viktimat të dhunës në familje duke mundësuar strehim, ushqim, siguri dhe këshillim psikologjik.

Ndihma ekonomike

Çdo viktimë e dhunës në familje e përfiton në përputhje me ligjin ndihmën ekonomike, megjithatë theksohet nevoja për përjashtimin nga pagesa e kopshti/çerdhes për fëmijë të viktimave të dhunës në familje.

Strehimi social

Edhe pse ndryshimet ligjore kanë sjellë hapësirën që në rast dhune të largohet dhunuesi nga banesa, në praktikë gjatë menaxhimit të rasteve vijon që zgjidhja të jepet përmes largimit nga banesa të viktimës. Sipas të dhënave të strukturës së strehimit social gjatë vitit 2022 kanë përfituar nga programet e strehimit dy viktimat të dhunës në familje. Ndërkohë UNDP ka mbështetur 21 raste viktimash të dhunës në familje me qera banese.

Këshillim ligjor dhe shërbim psikosocial

Mundësohen nga Koordinatorin dhe psikologu i strehezes 72 orëshe. Gjithashtu koordinatori vendor për masa kundër dhunës në familje koordinon me TLAS për shërbimin ligjor falas.

Punësimi

Gjatë vitit 2022 përfituan nga programet e punësimit 13 viktimat të dhunës në familje dhe një viktimë përfitoi gjithashtu nga programi i formimit profesional. Vihet re një tendencë e viktimave të dhunës që edhe pse u ofrohen oferta pune të mos i pranojnë ato. Ka raste që shkaktohet lidhen me kujdesin ndaj fëmijës, sikurse edhe raste që nuk ka shkaqe të arsyeshme për mos pranimin e ofertës së punës.

Shërbim mbështetës për fëmijët

Për fëmijët Bashkia mundëson mbështetje psikologjike, mbështetje në qendrën komunitare për detyrat e shtëpisë, vleresime psikologjike me ekspert.


2.4. Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje

✓ *Madhësia, karakteristikat e grupit dhe shtrirja në territor*

Për të analizuar nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror të fëmijëve në territorin e Bashkisë u mbledhën të dhëna të vitit 2022 mbi : (i) fëmijë pjesë e familjeve përfituese të NE, (ii) fëmijë me aftësi të kufizuara dhe (iii) raste të menaxhuara të fëmijëve të identifikuar në rrezik.


Për grupin e parë dhe të dytë të të dhënave u përdorën treguesit statistikor që mblidhen periodikisht nga administratorët shoqërorë dhe raportohen në ShSSH, ndërsa për grupin e tretë të dhënat u raportuan nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës.

G. 13. FEMIJE NE NEVOJE PER MBROJTJE/PERKUJDESJE



Bazuar në të dhënat e marra nga të tre burimet mund të themi se në territorin e Bashkisë Berat janë 1,183 fëmijë që kanë të nevojshëm të paktën një formë shërbimi mbrojtje apo përkujdesi social. Vetëm 4% e këtij totali në fakt janë raste të menaxhuara nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve gjatë vitit 2022. Ndërkohë 53% e totalit janë fëmijë që bëjnë pjesë në familjet përfituese të ndihmës ekonomike dhe 43% janë fëmijë me aftësi të kufizuara. Në grafik 14 jepet shpërndarja në territor të fëmijëve që kanë nevojë për mbrojtje/përkujdesje dhe siç shihet 57% e tyre jetojnë në qytetin e Beratit, në Otlak (10%), Sinje 18%, Velabisht 9% dhe Roshnik 6%.

G.14. FEMIJE NE NEVOJE PER MBROJTJE/ PERKUJDESJE



Rastet e menaxhuara nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës (49 raste) i përkasin vetëm territoreve të njësive administrative Berat (94%) e rasteve, Roshnik (4%) dhe Velabisht (2%) e rasteve.

✓ *Identifikimi dhe menaxhimi i rasteve*

Bashkia ka ngritur mekanizmin lokal të koordinuar për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje.

✓ *Shërbimet për fëmijët*

Shërbimet sociale

Përveç qendrës “Lira” që mundëson shërbime për fëmijë me aftësi të kufizuara (shih seksionin e aftësisë së kufizuar) Qendra Multifunkionale e Bashkisë mundëson shërbim me klasa mbështetëse për fëmijë, si dhe shërbim psikologjik. Megjithatë qendra frekuentohet nga një numër i kufizuar fëmijësh dhe vetëm nga territori i qytetit Berat.

Shërbimi në çerdhe dhe kopshte

Janë 4 çerdhe funksionale vetëm në territorin e qytetit Berat të cilat operojnë mbi kapacitetin e tyre: kapaciteti maksimal i tyre është për 230 fëmijë, ndërkohë që marrin shërbim 247 fëmijë. Janë 40 kopshte të shpërndara në të gjithë territorin e bashkisë nëse të cilat marrin shërbim 1,206 fëmijë.

Bashkia aplikon masa lehtësuese për përfshirjen në çerdhe dhe kopshteve të fëmijëve të familjeve vulnerabel, specifikisht duke hequr pagesën për fëmijë nga familje rome/egjiptiane dhe fëmijë me status jetimi.

Arsimi për fëmijët⁸

Janë 37 shkolla nëntëvjeçare në këtë Bashki në të cilat arsimohen 4,570 nxënës. Në 9 shkollat e mesme në këtë Bashki (katër prej të cilave në Berat dhe të tjerat në njësi administrative) arsimohen 1,624 të rinj. Në shkolla ka psikologë edhe pse nuk u raportuan nga struktura arsimi numri i saktë i tyre. Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës bashkëpunon ngushtë me shkollat për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve. Është i nevojshëm trajnimi i mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara.

2.5. Familjet rome dhe egjiptiane⁹

Bashkia Berat ka miratuar dhe po zbaton që prej vitit 2022 Planin Vendor të Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane, si dhe të Kthyerve nga Emigrimi dhe Azili (2022-2025). Çështjet e identifikuar në këtë Plan Social, si dhe prioritetet janë në një linjë me Planin për Integrim të pakicave Rome dhe Egjiptiane. Specifikisht në këndvështrimin e mbrojtjes dhe përkujdesit social në Planin Vendor të Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane (PVVIPRE) Bashkia Berat është angazhuar për programe të përmirësuar të mbrojtjes sociale ofruar për anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane, përfshirë edhe familjeve të kthyer nga emigrimi apo azili.

✓ Madhësia, karakteristikat e grupit dhe shtrirja në territor

Në bashkinë e Beratit ka një komunitet të rëndësishëm rom dhe egjiptian, me rreth 13,679 banorë - 89% egjiptianë dhe 11% romë - shumica e tyre jetojnë në qytetin e Beratit dhe në njësinë administrative Otlak¹⁰. Komuniteti egjiptian dhe rom në bashkinë e Beratit përbën 13.7% të popullsisë së përgjithshme të saj.

Ndonëse nuk disponohen të dhëna të sakta dhe të përditësuara, raportet/dokumentet e mëparshme dhe të dhënat e siguruar gjatë muajit dhjetorit 2021, konfirmojnë për një numër të përafërt prej 3,610 familjesh egjiptiane me rreth 12,174 individë, si dhe 330 familje rome

⁸ Për fëmijët me aftësi të kufizuara referojuni seksionit për personat me aftësi të kufizuara të këtij Plani

⁹ Për më shumë detaje referoju Planit të Veprimit për Përfshirjen e Pakicave Rome dhe Egjiptiane

¹⁰ Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane, si dhe të Kthyerve nga Emigrimi dhe Azili (2022-2025), faqe 10

me 1,504 individë. Në përgjithësi, anëtarët e pakicave egjiptiane janë integruar më mirë dhe hendeuku me popullsinë kryesore është më i ngushtë në krahasim me atë të pakicës rome¹¹.

Për të identifikuar madhësinë e grupit të individëve romë që kanë të nevojshme shërbime mbrojtje apo përkujdesi social u morrën të dhëna nga tre burime kryesore: (1) Administratorët shoqërorë për familjet përfutuese të ndihmës ekonomike ; (2) Drejtoria e Strehimit në Bashki për programet e strehimit: (3) Zyra e punës për të identifikuar punëkërkuesit e papunë.

Të dhënat e Rregjistrit Elektronik Kombëtar të Ndhmës Ekonomike për muajin qershor 2023, japin 48 familje rome përfutuese të ndihmës ekonomike. 73% e të cilave banojnë në territorin e qytetit Berat, 25% në njësinë administrative Otllak dhe 2% në Velabisht. Referuar numrit të përgjithshëm të familjeve rome në territor, 15% e tyre mbështeten përmes ndihmës ekonomike. Sipas të dhënave të Zyrës së Punës janë rregjistruar si punëkërkues të papunë në këtë Bashki 200 individë romë, 61% e të cilëve i përkasin grupmoshës mbi 40 vjeç.

PVVIPRE ka theksuar një numër problematikash për strehimin e familjeve rome dhe egjiptiane.


✓ *Shërbimet për familjet rome dhe egjiptiane*

Ndihma ekonomike, strehimi social dhe shërbime përmes Qendrës Multifunksionale janë tre format e shërbimeve që Bashkia Berat mundëson për familje dhe individë në nevojë nga ky grup.

Zyra e Punës specifikon që për vitin 2022 nga 200 individë romë/egjiptianë të rregjistruar si punëkërkues 36 u punësuan (18% e këtij grupi).

2.6. Të moshuarit në nevojë për shërbime sociale

✓ *Madhësia, karakteristikat e grupit dhe shtrirja në territor*



Janë të paktën 72 të moshuar që kanë kërkuar nga Bashkia Berat të paktën një formë shërbimi mbrojtje (pagesë) ose përkujdesi shoqëror. Nga të dhënat e rregjistrit elektronik të ndihmës ekonomike del se 3% e përfutuesve janë persona mbi 64 vjeç.

Ndërkohë të dhënat e raportuara nga administratorët shoqëror të moshuarit që përfitojnë ndihmë ekonomike zënë 71% të të

moshuarve që kanë kërkuar të paktën një formë mbështetje apo shërbimi social nga Bashkia. Siç shihet në grafik 11% e kërkesave lidhen me nevojën për shërbim në familje, 10% janë në

¹¹ Idem, Faqe 12

kërkim të strehimi social, 5% kanë kërkuar shërbim rezidencial dhe 3% shërbim në qendër ditore.


Grafiku 16 jep shpërndarjen e kërkesave në njësi të ndryshme administrative. Siç shihet 56% e kërkesave i përketin njësisë së qytetit Berat, Sinjë 19%, Otlak 10%, Velabisht 10% dhe Roshnik 5%.

✓ **Identifikimi i rasteve të të moshuarve në nevojë për shërbime**

Nuk ka një mekanizëm të ngritur për identifikimin në territor të rasteve që kanë nevojë për përkujdesje. Kryesisht individët në nevojë i drejtohen vetë Bashkisë.

✓ **Sherbimet e kujdesit shoqëror**

Kryqi i Kuq ofron shërbim për 40 të moshuar në vit përmes qendrës ditore të ngritur në ambjentet e një prej godinave në pronësi të Bashkisë Berat. Shërbimi shëndetësor, këshillimit psikologjik, kafe-çaj dhe aktivitete sociale janë shërbimet që mundësohen në këtë qendër. Mungesa e mjetit të transportit e bën shërbimin të aksesueshëm vetëm për të moshuar nga territori i qytetit Berat.



2.7. Personat me varësi nga droga dhe nga alkooli

✓ **Madhësia e grupit dhe shtrirja në territor**

Ka një numër shumë të vogël rastesh të identifikuar dhe të raportuara nga Policia të personave me varësi nga droga dhe nga alkooli. Këto struktura kanë raportuar 6 raste të persona me varësi nga alkooli banues në territorin e qytetit Berat dhe vetëm një rast varësie nga droga nga po i njëjti territor. Ndërsa struktura e Bashkisë raporton 72 raste të përdoruesve të drogave në territorin e njësisë administrative Berat. Në fakt këto nuk janë raste të identifikuar nga vetë strukturat e Bashkisë, por nga partneriteti i saj me Aksion Plus, një organizatë që mundëson trajtimin me metadon të përdoruesve të drogës.

✓ **Identifikimi i rasteve**

Nuk ka mekanizëm të ngritur për këtë qëllim. Bashkia vetë bashkëpunon me Aksion Plus nga dhe janë siguruar të dhënat e raportuara në funksion të përgatitjes së këtij Plani.

✓ **Sherbimet e kujdesit shoqëror**

Mungojnë shërbimet për këtë grup.

3. KAPACITETET E BASHKISË

3.1 Burimet njerëzore

Janë tre komponentë kyç që u analizuan në këndvështrimin sasior dhe cilësor të burimeve njerëzore të domosdoshme për funksionimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë: (1) struktura përgjegjëse në nivelin e Bashkisë; (2) Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (njësia administrative); (3) shërbimet sociale egzistuese.

(1) Struktura përgjegjëse në nivelin e Bashkisë

Drejtoria e shërbimit social në Bashki është e organizuar në dy sektorë dhe ka 15 punonjës.

Spektori i ndihmës ekonomike përbëhet nga shtatë punonjës, të cilët janë përgjegjës për administrimin e programeve të mbrojtjes sociale (ndihma ekonomike dhe aftësia e kufizuar).

Spektori i shërbimeve shoqërore përbëhet nga staf që ofron shërbime (strehëza emergjente për viktimat e dhunës dhe njësia lëvizëse) si dhe Koordinatorin Vendor për masa kundër dhunës në familje dhe Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës.

Drejtoria përmbush këto funksione: Administrimi i pagesave të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar; Mbrojtja dhe përkujdesi i fëmijëve; Barazia gjinore; Masa kundër dhunës në familje; Planifikimi strategjik i shërbimeve të kujdesit shoqëror; Ngritja e shërbimeve dhe monitorimi i cilësisë;

Nuk përfshihen në funksionet e drejtorisë: Identifikimi i nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror në territorin në juridiksionin e bashkisë; Prokurimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror; Përfshirja dhe aksesueshmëria e personave me aftësi të kufizuara.

Në këndvështrimin e planifikimit dhe ngritjes së shërbimeve Drejtoria ka hartuar dhe zbatuar dy Plane Sociale që nga koha e miratimit të Ligjit për shërbimet e kujdesit shoqëror, megjithatë vlerëson se vetëm 25% e Planit më të fundit social është zbatuar për arsye që lidhen veçanërisht me: (1) mungesa e buxhetit dhe (2) mungesa e kapaciteteve të stafit për të hartuar projekte në fushën sociale.

Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale vlerëson se personeli egzistues nuk është i mjaftueshëm. Është i nevojshëm shtesa në strukturë e: (i) 1 punonjës për identifikimin e nevojave, NJVNR; (ii) 1 punonjës për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave AK.

Struktura përgjegjëse e shërbimit social të Bashkisë nuk ka Plan për trajnimin dhe formimin e kapaciteteve të stafit të saj dhe Njësitë të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit.

Drejtoria e shërbimit social ndërvepron me Drejtorinë e Strehimit, të Financave, Projekteve, Arsimit, Rinisë dhe Sporteve për të adresuar nevojat specifike në fushën e mbrojtjes dhe përkujdesit social.

Kjo Drejtori ka ngritur partneritetin gjithashtu me Zyrën e Punësimit dhe Aftësimin; Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social; Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, ZVA Berat; Drejtorinë

Vendore të Policisë dhe Shërbimin e Provës me të cilat ndërvepron veçanërisht për menaxhimin e rasteve sociale.

Gjithashtu Drejtoria e shërbimit social ka ndërtuar partneritet me organizata dhe ofrues shërbimesh në funksion të menaxhimit të rasteve sociale si dhe të fushatave të informimit që targetojnë grupet në situatë vulnerabiliteti. YËCA, “Mjedisi dhe Komuniteti”, “National Center for Community”, Nisma “ARSIS”, “Vatra” dhe “Të Ndryshëm të Barabartë” janë organizatat me të cilat kjo drejtori ka ndërvepruar apo ndërvepron.

(2) Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit

Tabela 3: Struktura sipas parashikimeve ligjore

Njësia	Popullsia	STRUKTURA E NJVNR SIPAS LIGJIT			Punonjës
		Punonjës social (menaxher rasti)	PMF	Administrator shoqëror	
administrative					aktualisht
Berat	63400	6	2	4	4
Velabisht	11950	1		1	1
Roshnik	3574			1	1
Sinje	5174			1	1
Otlak	15637	2		1	1
TOTALI	99635	8	2	8	8

Sikurse konfirmon edhe drejtori i Drejtorisë së Shërbimit social aktualisht ka mungesë personeli për të përmbushur detyrat e NJVNR.


(3) Shërbimet sociale që administrohen e menaxhohen nga Bashkia

Sikurse u shpjegua gjatë analizës së çdo grupi në nevojë për shërbime në territorin e Bashkisë funksionojnë:

- Qendra “Lira” që ofron shërbime për persona me aftësi të kufizuara
- Qendra rezidenciale për personat me aftësi të kufizuara
- Qendra Multifunkionale Komunitare
- Strehëza emergjente 72 orë për viktime të dhunës në familje
- Qendra Ditore për të moshuarit (partneritet me Kryeqin e Kuq)
- Skuadra e Terrenit

Analiza dhe konsultimet e kryera treguan që shërbimet duhet të zgjerohen dhe duhen ngritur shërbime të reja për të plotësuar nevojat jo vetëm për qendrën e Bashkisë, por për gjithë territorin e saj.

4. ANALIZA SWOT



5. MISIONI, VIZIONI DHE PARIMET UDHËRRËFYESE

5.1 Misioni

Bashkia Berat përmes angazhimit të burimeve njerëzore e financiare të nevojshme, zhvillimit të partneritetit aktiv me çdo institucion publik që ka role e përgjegjësi specifike ligjore kundrejt individëve në nevojë për shërbime, do të thellojë e përmirësojë sistemin aktual të shërbimeve të kujdesit shoqëror për të mbrojtur, fuqizuar e riintegruar çdo individ të rrezikuar nga varfëria apo përjashtimi social.

5.2 Vizioni

Sistem komunitar shërbimesh të kujdesit social efektiv dhe gjithëpërfshirës që adreson nevojat në ndryshim të individëve në rrezik nga varfëria apo përjashtimi social duke u mundësuar sipas nevojës fuqizim, rehabilitim, riintegrim në jetën ekonomike dhe sociale.

5.3 Parimet udhërrëfyese

Parimi i universalitetit. Shërbimet e kujdesit shoqëror do të krijohen, funksionojnë dhe mbikëqyren bazuar në një *sistem rregullash ligjore* që ofrojnë garanci të mjaftueshme për t'u zbatuar në mënyrë të njëjtë për përfituesit që ndodhen në të njëjtat kushte.

Parimi i drejtësisë sociale. Çdokush ka detyrim të sigurojë kushtet bazë të jetesës për veten dhe personat për të cilët ka detyrim ligjor t'i mbështesë dhe çdokush ka detyrim të kontribuojë me punën, të ardhurat dhe pasuritë e tij/saj për reduktimin e gjendjes së varfërisë së tij/saj apo të anëtarëve të familjes, veçanërisht fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë që nuk janë në gjendje të kujdesen për veten e tyre.

Parimi i mbështetjes shoqërore. Individët, të cilat përmbushin kushtet për të përfituar nga shërbimet e kujdesit shoqëror, do të kenë të drejtën e përdorimit të tyre në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe për aq kohë sa janë në kushtet e vështirësisë e të pamundësisë.

Parimi i deinstitucionalizimit. Shërbimet e kujdesit shoqëror do të sigurohen dhe ofrohen, për aq sa është e mundur, pranë familjes ose komunitetit të përfituesit të shërbimit, me qëllim sigurimin e mirëqenies shoqërore dhe përdorimin me efikasitet të fondeve.


Parimi i partneritetit. Funksionimi i sistemit të shërbimeve shoqërore do të bazohet në një *bashkëpunim të ngushtë midis qeverisjes qendrore dhe vendore*, si financues kryesorë të shërbimeve shoqërore me organizatat jofitimprurëse dhe subjektet e tjera jopublike, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre ofrimin e shërbimeve shoqërore për individët dhe familjet që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

Parimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe integritetit të përfituesit. Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror do të bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut, integritetit të individit, besimit fetar dhe formimin e gjithanshëm të tij.

Parimi i mosdiskriminimit. Do të ndalohet çdo formë e diskriminimit të përfituesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në shkaqet e përmendura në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Parimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Të dhënat personale të individit, që trajtohet me shërbime të kujdesit shoqëror, do të jenë konfidenciale dhe do të mbrohen e përpunohen sipas ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Punonjësi social, si dhe çdo person tjetër i angazhuar në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror do të ruajë konfidencialitetin e të dhënave personale të individit për të cilat ka marrë dijeni si pasojë e funksionit apo detyrës që kryen.

6. QËLLIMET, OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET



Qëllimi 1: Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve, infrastrukturës dhe burimeve financiare të Bashkisë për t'ju përgjigjur cilësisht me shërbime sociale nevojave të komunitetit

Objektivi 1. Personeli përgjegjës për shërbimet sociale në të gjitha nivelet e organizimit do të jetë i përgatitur dhe ka burimet e nevojshme për të përmbushur cilësisht funksionet e tyre ligjore

Aktivitetet:

1.1.1 Riorganizim i Drejtorisë së Shërbimit Social në përputhje me parashikimet ligjore

Drejtoria e shërbimit social në Bashki do të jetë struktura që do të përmbushi funksionet e planifikimit strategjik të shërbimeve të kudjesit shoqëror në territorin e Bashkisë, ngritjes së shërbimeve sociale, monitorimit të cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve, ndërtimin e partneriteteve me institucione publike dhe ofrues shërbimesh jo publike e organizatash në përputhje me zbatimin e prioritetëve strategjike.

Përveç drejtorit në përbërje të drejtorisë do të jenë: (1) koordinatori për fuqizimin ekonomik-specialisti përkatës do të jetë përgjegjës jo vetëm për mbikqyrjen e zbatimit të programit të pagesave cash (ndihma ekonomike dhe pak) nga stafi përkatës i NJVNR (administratorët shoqëror dhe specialistët e PAK), përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni mbi personat me aftësi të kufizuara, por edhe për zbatimin e komponentit të fuqizimit ekonomik të këtij plani; (2) koordinatori për shërbimet sociale- do të jetë përgjegjës për procedurat e miratimit të marrjes së shërbimeve pas vlerësimeve të kryera nga NJVNR, për procedurat e ngritjes së shërbimeve komunitare, ndërtimin dhe zbatimin e planit të trajnimeve sipas nevojave si të stafit të NJVNR ashtu edhe të stafeve të shërbimeve sociale të ngritura nga Bashkia; (3) specialist për monitorimin e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve sociale të Bashkisë, si dhe për përgatitjen e projekt-propozimeve për ngritjen e shërbimeve të parashikuara dhe aplikimin pranë institucioneve kombëtare dhe donatorëve vendas e të huaj; (4) NJMF- specialisti do të përmbush të gjitha funksionet e parashikuara në ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës; (5) Koordinatore vendore për masa kundër dhunës në familje dhe barazinë gjinore- do të përmbush funksionet e parashikuara në legjislacionet respektive.

Drejtoria e shërbimit social do të udhëheqë strukturat që bëjnë të mundur : (i) identifikimin proaktiv të rasteve dhe menaxhimin efektiv të tyre dhe (ii) ofrimin e shërbimeve sociale publike në territorin e Bashkisë. Kjo nënkupton që në varësi të Drejtorisë së Shërbimit Social do të jetë Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, si dhe çdo shërbim emergjence, në familje, komunitar dhe rezidencial publik që është egzistues apo që do të ngrihet gjatë zbatimit të këtij plani.

1.1.2 Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit

Do të ketë varësi të drejtpërdrejtë nga Drejtoria e Shërbimit Social në Bashki dhe do të ketë në përbërje: (1) administratorët shoqëror (6 specialistë) për ndihmën ekonomike- do të përmbushin detyrimet ligjore që rrjedhin nga ligji për asistencën sociale, si dhe do të ndërveprojnë me punonjësit social për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve të familjeve pa të ardhura/me të ardhura të pamjaftueshme; (2) specialistë të aftësisë së kufizuar (2 punonjës)- do të përmbushin detyrimet ligjore që rrjedhin nga ligji për asistencën sociale dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, si dhe si dhe do të ndërveprojnë me punonjësit social për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve të personave me aftësi të

kufizuara; (3) Menaxherë të rastit (2 punonjës)- kanë detyrë identifikimin proaktiv të rasteve dhe menaxhimin efektiv të tyre për të gjithë territorin e Bashkisë.

1.1.3 Sistemi publik lokal i shërbimeve sociale

Pjesë e këtij sistemi do të jenë të gjitha shërbimet e emergjencës, komunitare, në familje dhe rezidenciale publike të ngritura aktualisht apo që do të ngrihen në periudhën e zbatimit të këtij plani (shih objektivin 3). Të gjitha shërbimet do të jenë në varësi të Drejtorisë së Shërbimit Social të Bashkisë Berat.

1.1.4 Përgatitja e stafëve për t'ju përgjigjur cilësisht detyrave sipas pozicionit

Drejtoria e shërbimit social në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore do të përgatisë përshkrimet e punës për çdo pozicion si të stafit të Drejtorisë ashtu edhe Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit. Përshkrimet e punës do të bëhen pjesë e rregullores së Bashkisë Berat.

Për çdo ndryshim në shërbimet egzistuese komunitare të ngritura nga Bashkia apo shërbim të ri që do të ngrihet në përputhje me parashikimet e këtij Planit Drejtoria e Shërbimit Social do të jetë përgjegjëse për ndërmarrjen e procedurave të nevojshme për ngritjen e shërbimit, miratimin në këshill bashkiak, si dhe licencimin e shërbimit sipas parashikimeve ligjore.

Vlerësimi i performacës së stafëve në të gjitha strukturat do të bëhet në përputhje me përshkrimet e punës së miratuara.

Drejtoria e shërbimit social do të identifikojë brenda gjashtëmujorit të parë të zbatimit të këtij plani nevojat për trajnime të të gjithë personelit (në Drejtori, NJVNR dhe shërbime sociale në varësi të saj) dhe do të organizojë të paktën tre trajnime në çdo vit për stafet sipas nevojave të identifikuar.

1.1.5 Garantimi i infrastrukturës dhe mjeteve të përshtatshme të punës për të gjitha strukturat


Drejtoria e shërbimit social do të vlerësojë gjendjen e ambjenteve të punës së stafit të NJVNR dhe mjeteve të punës brenda gjashtëmujorit të parë të zbatimit të këtij plani. Mbi bazën e vlerësimit do të parashikojë fondet e nevojshme për të përmirësuar kushtet e punës (ambjenti fizik i përshtatshëm për të ruajtur konfidencialitetin gjatë intervistimit, si dhe pajisjet e punës të përshtatshme sipas çdo pozicioni pune). Gjithashtu ajo do të përgatisë sipas nevojës udhëzime apo procedura pune që lehtësojnë ndërveprimin mes punonjësve apo përmbushjen e detyrave specifike të tyre.

Në periudhën e hartimit të buxhetit të Bashkisë për vitin pasardhës Drejtoria e Shërbimit Social do të koordinojë si me NJVNR ashtu edhe me çdo shërbim social në varësi të saj me qëllim përgatitjen e buxheteve realiste dhe që përmbushin të gjitha nevojat.

1.1.6 Thithja e fondeve

Siç u specifikua në aktivitetin 1.1.1 të këtij Planit Drejtoria e shërbimit social do të ketë një specialist për monitorimin e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve sociale të Bashkisë, si dhe për përgatitjen e projekt-propozimeve për ngritjen e shërbimeve. Specialisti/ja do të bashkëpunojë me strukturën përgjegjëse në Bashki për projektet me qëllim identifikimin e donatorëve të mundshëm dhe përgatitjen e projekt-propozimeve sipas prioriteteve të përcaktuara në këtë Plan Social. Këtu përfshihen edhe projekt-propozimet për të suguruar financim nga Ministria përgjegjëse për mbrojtjen dhe kujdesin social.

REFERIMI DHE MENAXHIMI I RASTIT NE SISTEMIN KOMUNITAR TE SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR



Qëllimi 2. Konsolidim i mekanizmave ndërsektorial egzistues dhe zgjerim me mekanizma të rinj për identifikim dhe adresim efektiv të nevojave të grupeve vulnerabël

Objektivi 1: Zgjerim i mekanizmit dhe ndëveprimit për të mundësuar riintegrim ekonomik e social të individëve në situatë vulnerabël

Aktivitetet

2.1.1 Zgjerim i mekanizmit egzistues për fuqizimin dhe riintegrimin ekonomik e social

Koordinatori për fuqizimin ekonomik në Drejtorinë e Shërbimit Social gjatë vitit të parë të zbatimit të Planit në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për taksat do të ndërtojë bazën e të dhënave të bizneseve që kanë potenciale punësimi në të gjithë territorin e Bashkisë. Në përfundim të këtij procesi Bashkia do të thërras në një tryezë të gjithë drejtuesit e bizneseve, përfaqësues të Zyrës së Punës, Formimit Profesional, Agjensisë së Zhvillimit të Bujqësisë dega Rajonale Berat, si dhe organizata joqeveritare të identifikuar që zhvillojnë projekte të fuqizimit ekonomik. Tryeza do të synojë: (i) të rrisë ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve që kanë kapacitete për punësim për nevojën e përfshirjes në tregun e punës së individëve në moshë pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, si dhe në mënyrë të veçantë grave kryefamiljare, viktimave të dhunës në familje, personave me aftësi të kufizuara; (ii) të diskutohen forma të ndërveprimit mes Bashkisë-biznesit-Zyrës së Punës-AZHB- Formimit profesional me qëllim përmbushjen e objektivit të fuqizimit ekonomik të familjeve në qytetin e Berat dhe dy njësive administrative Sinjë dhe Roshnik (këto dy të fundit me nivelin më të lartë të varfërisë në këtë Bashki). Mbi bazën e konkluzioneve të tryezës koordinatori për fuqizimin ekonomik do të ndërtojë një Plan-Veprimi mes aktorësh me target punësimin e familjeve dhe individëve pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme dhe grupeve prioritare për punësim. Masat e këtij Plani do të përforcojnë masat e parashikuara në Planin Social që do të ndërmarrë vetë Bashkia Berat në funksion të fuqizimit ekonomik. Në secilin nga dy vitet pasuese të këtij Plani kjo tryezë do të rimblidhet për të diskutuar mbi rezultatet, sfidat dhe përmirësimet e mundshme.

2.1.2 Këshillimi për punësim dhe ofertat e punës

Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit do të vijojë të bashkëpunojë me specialistët e Zyrës së Punës për të përgatitur skemat për punësim, por edhe për të ndërgjegjësuar çdo individ në vështirësi ekonomike mbi domosdoshmërinë e pranimin të ofertës së punës dhe shmangien e punës në të zezë. Përfaqësuesi i Zyrës së Punës së bashku me administratorin shoqëror do të zhvillojnë në ambjentet e njësive administrative respektive takime informuese dhe këshilluese me individët madhorë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike. Këshillimet do të zhvillohen dy herë në vit pranë çdo njësie administrative. Takimet këshilluese do të targetojnë gjithashtu personat me aftësi të kufizuara për përfshirjen e tyre në tregun e punës. Në fund të çdo viti Drejtoria e Shërbimit Social, NJVNR dhe Zyra e Punës do të diskutojnë në një tryezë pune mbi arritjet dhe sfidat e punësimit gjatë vitit specifik dhe do të planifikojnë masat për vitin pasues.

2.1.3 Masa të Bashkisë për fuqizimin ekonomik

Përveç masave të parashikuara nga ngritja e mekanizmit ndërinstitucional Bashkia Berat do të ndërmarrë:

1. Në vijim të takimit të parë të mekanizmit lokal të ngritur, Bashkia, Zyra e Punës dhe Qendra publike e jopublike të formimit profesional do të ngrenë një grup teknik të përbashkët për të kryer një vlerësim më të thelluar të karakteristikave të tregut të punës në këtë Bashki. Synimi do të jetë identifikimi i profileve të ndryshme të punës në mënyrë që edhe formimi profesional të jetë i orientuar drejt atyre kurseve që i përgatisin realisht për punë individët në moshë pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, personave me aftësi të kufizuara, grave kryefamiljare, viktimave të dhunës në familje. Produkt i punës së këtij grupi do të jetë listimi i profesioneve që mund të ushtrohen realisht në territorin e Bashkisë në përputhje me karakteristikat e tregut të punës. Në përputhje me këtë listë shërbimet e formimit profesional do të orientojnë kurset që u ofrojnë individëve në kërkim të një pune.

2. Punësim i të rinjve të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike. Çdo vit 3 të rinj të sapodiplomuar, kryesisht të familjeve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, do të punësohen për gjashtë muaj sipas profesionit që kanë në biznese lokale apo në Bashki. Bashkia do të financojë për pagat e tyre në masën 26.000 lekë/muaj.

3. Koordinator i për fuqizimin ekonomik do të ndërveprojë me drejtorinë e burimeve njerëzore, si dhe me drejtoritë e Bashkisë që menaxhojnë kontrata publike për të mundësuar punësimin e individëve nga grupet prioritare të këtij plani (gra kryefamiljare, persona me aftësi të kufizuara, viktimat e dhunës në familje). Target: të paktën 10 individë nga këto grupe do të jenë të punësuar çdo vit.

Objekti 2. Ngritja e mekanizmit të koordinuar për adresimin efektiv të nevojave të personave me aftësi të kufizuara

Aktivitetet:

2.2.1 Ngritja dhe funksionimi i mekanizmit

Përveç Bashkisë janë tre institucione që kanë role e përgjegjësi specifike për adresimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuara: arsimit, shëndetësisë, zyra e punës. Të katër institucionet duhet të punojnë në partneritet si në këndvështrimin e shkëmbimit të informacionit, referimin, si dhe ofrimin e shërbimit përgjatë menaxhimit të rasteve sociale. Në muajt e parë të zbatimit të Planit Social Drejtoria e shërbimit social do të thërrasë një tryezë me përfaqësues të tre institucioneve, si dhe Qendrës “Lira”, Qendrës “Unë jam si ju” dhe Qendrave Multifunksionale, si dhe çdo organizatë që punon në këtë fushë. Në tryezë do të përcaktohen format e bashkëpunimit, si dhe do të specifikohet rrjeti i specialistëve nga secili institucion që do të angazhohet në vijim. Tryeza do të mbledhet dy herë në vit për të analizuar arritjet, diskutuar sfidat dhe parashikuar masat në vijim.

2.2.2 Identifikimi i rasteve në nevojë për shërbime

Shkëmbimi i informacionit mes strukturave të Bashkisë, të arsimit dhe shëndetësisë do të synojë të mundësojë identifikimin e çdo individit që ka të nevojshëm si përfshirjen në sistemin e pagesave kesh, ashtu dhe individët që kanë të nevojshme përfshirjen në shkollë apo marrjen e shërbimeve të rehabilitimit dhe zhvillimit. Në mënyrë të veçantë do të synohet identifikimi i rasteve të fëmijëve që kanë të nevojshëm ndërhyrjen e herëshme, fëmijët parashkollorë që janë në rrezik për të zhvilluar aftësi të kufizuar apo kanë lindur me aftësi të kufizuar fizike, mendore, shqisore etj. Synimi do të jetë që fëmijës ti ofrohet ndërhyrje terapeutike multidisiplinare sipas nevojave të veçanta që paraqet (terapist të foluri, fizik, okupacional, etj.) në mjedisin ku fëmija ushtron aktivitetin e përditshëm (në kopësht, shkollë apo qendrën ditore). Ndërveprimi me sistemin arsimor lokal do të jetë prioritet për të mundësuar këtë formë shërbimi. Ndërveprimi me Zyrën e Punës do të synojë rritjen e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës.

2.2.3 Rritja e aksesit të personave me aftësi të kufizuara në mjedisin publik dhe në shërbime

Bashkia Berat brenda vitit të dytë të zbatimit të Planit Social do të ngrejë një grup pune miks me përfaqësues nga Drejtoria e shërbimit social dhe drejtorive të linjës në këtë Bashki (transport, urbanistikë, financë), i cili do të punojë për të identifikuar barrierat egzistuese me të cilat ndeshen personat me aftësi të kufizuara në mjedisin fizik, në transport dhe marrjen e shërbimeve brenda përgjegjësisë së Bashkisë. Grupi do të hartojë një raport me rekomandime për eliminimin e këtyre barrierave.

Objektivi 3. Ngritje dhe funksionim i mekanizmit për veprim të koordinuar për adresimin e nevojave të të moshuarve

Aktivitetet

2.3.1. Krijimi i strukturave koordinuese për mbështetjen e të moshuarve

Në kushtet që mjekët e familjes janë më pranë të moshuarve Drejtoria e shërbimit social do të krijojë partneritetin me strukturat shëndetësore për të identifikuar vendndodhjen dhe nevojat e të moshuarve të sëmurë në nevojë për asistencë sociale dhe do të shkëmbejë informacion me ta në funksion të këtyre nevojave. Si hap i parë Drejtoria e shërbimit social do të mbledhë në një tryezë përfaqësues të shëndetësisë, Kryqit të Kuq, Qendrave Multifunkionale dhe çdo organizatë në territor që punon për këtë grup. Në tryezë do të diskutohet forma e bashkëpunimit dhe rrugët epr shkëmbim informacioni. Në vijim të tryezës çdo e dhënë e strukturave shëndetësore do të përcillet pranë Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit ku ka vendbanimin çdo i moshuar në nevojë për shërbim me qëllim vlerësim më të thelluar të nevojës dhe referimin tek shërbimet specifike.

2.3.2 Rritja e aksesit të të moshuarve në transportin publik

Me qëllim rritjen e aktivitetit dhe mundësitë e të moshuarve për tu integruar në shoqëri dhe për të përdorur shërbimet janë të nevojshme lehtësitë për të përdorur transportin në mjedisin urban. Drejtoria e shërbimit social do të identifikojë numrin e të moshuarve në nevojë, të tillë si të moshuar që përfitojnë pensjon social, apo që kanë të nevojshëm shërbime të kujdesit shoqëror. Në ndërveprim me drejtorinë përgjegjëse në Bashki për çështjet e transportit publik do të vlerësojnë mundësitë për subvencionimin e këtij transporti për këto grupe.

Objekti 4. Ngritje e mekanizmit lokal për veprim të koordinuar për rehabilitimin e përdoruesve të drogës

Aktivitetet:

2.4.1. Krijimi i strukturave koordinuese për identifikimin e rasteve

Mjekët dhe punonjësit e policisë bien në kontakt të drejtpërdrejtë me përdoruesit e drogës apo alkoolit. Aktualisht mungon një sistem i regjistrimit të përdoruesve, si dhe referimit të tyre tek shërbimet. Për të adresuar këtë mungesë Drejtoria e shërbimit social do të krijojë partneritetin me strukturat shëndetësore dhe të policisë së pari për tu informuar prej tyre për çdo rast të përdoruesve të drogës dhe alkoolit me qëllim ndjekjen e çdo rasti nga ekipet e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit. Çdo e dhënë e strukturave shëndetësore apo të policisë do të përcillet pranë Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit ku ka vendbanimin çdo person i identifikuar me qëllim vlerësim më të thelluar të nevojës dhe referimin tek shërbimet specifike.

Objekti 5: Konsolidim i mekanizmave egzistues për identifikimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin e fëmijëve dhe viktimave të dhunës në familje

Aktivitetet:

2.5.1. Konsolidimi i punës së grupeve teknike ndërsektoriale për mbrojtjen dhe kujdesin ndaj fëmijëve

Në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave 578 datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbytjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, Drejtoria e shërbimit social do të mbledhë në gjashtë mujorin e parë të zbatimit të këtij Planit grupin teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijës në nivel bashkie. Grupi teknik ndërsektorial ka në përbërje përfaqësues të strukturave të policisë, strukturave të shërbimeve sociale, përfaqësues të strukturave arsimore, shëndetësore, të drejtësisë, të organizatave jofitimprurëse, si dhe çdo specialist tjetër që ka njohuri për situatën e fëmijës ose që mund të kontribuojë në marrjen apo zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijës. Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës prezanton në takimin e parë të këtij grupi Planin e vitit të parë për ndërgjegjësimin mbi të drejtat e fëmijëve që përfshijn aktivitete ndërsektoriale që do të ndërmerren për të përmbushur këtë qëllim. Grupi teknik mbledhet më pas sa herë ka raste për të menaxhuar.

2.5.2. Konsolidimi i mekanizmit vendor për parandalimin e dhunës në familje dhe adresimin e nevojave të viktimave të saj

Në përputhje me VKM Nr.327 datë 2.6.2021, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”, Kryetari i Bashkisë do të thërrasë në një tryezë drejtuesit e institucioneve të parashikuara në këtë VKM për të qenë pjesë e Komitetit Drejtues për parandalimin dhe masat kundër dhunës në familje. Ky Komitet do të mbledhet në mënyrë periodike për të analizuar situatën e dhunës në familje. Koordinatori vendor për masa kundër dhunës në familje që është njëkohësisht drejtues i ekipit teknik ndërdisiplinor (të përbërë nga përfaqësues të institucioneve të përcaktuara nga Komiteti Drejtues në nivelin vendor), do të përgatisë për çdo mbledhje të Komitetit analiza/raportime mbi aktivitetet ndërsektoriale të ndërmarra për ndërgjegjësimin komunitar, si dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në familje.

Objekti 6. Identifikim proaktiv dhe menaxhim efektiv i çdo rasti në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje

Aktivitetet:

2.6.1 Ngritja e sistemit të integruar të referimit të rastit

Ku dhe si do të referohen rastet sociale, do të jetë objekt i punës së Drejtorisë Shërbimit Social në gjatëmujorin e parë të zbatimit të këtij Plan. Synimi është që të ngrihet sistemi i integruar i referimit të rastit duke përfshirë në të çdo institucion publik, ofrues shërbimesh dhe organizata që janë të angazhuara në këtë fushë. Pjesë e këtij sistemi do të jenë edhe kryetarët e fshatrave dhe ndërlidhësit e komunitetit. Të gjitha mekanizmat ndërsektorialë të ngritura do ti mundësojnë Drejtorisë së Shërbimit Social të ketë pikat e kontaktit pranë çdo institucioni dhe ofruesi shërbimesh në territor. Këto pika kontakti do të jenë të rëndësishme për Njësinë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit pasi do të shërbejnë si grupe teknike ndërsektoriale me përfaqësues të institucioneve publike dhe ofrues shërbimesh që përfshihen në territorin e njësisë përkatëse, me qëllim menaxhimin e rasteve përmes qasjes multisektoriale. Drejtoria e Shërbimit Social në Bashki do të ndërtojë modelin e punës për identifikimin proaktiv të rasteve sociale. Punonjësi social i NJVNR do të pajiset me një numër celulari që do të jetë publik me qëllim referimin e rasteve sociale. Sistemi i ngritur do të publikohet si në faqen elektornike të Bashkisë, ashtu edhe në ambjentet ku ofrohen shërbime nga Bashkia dhe aktorët e përfshirë në këtë sistem.

2.6.2 Menaxhim efektiv i rasteve dhe referimi tek shërbimet e kujdesit shoqëror

Menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje kryhet në përputhje me parashikimet në Vendimin e Këshillit të Ministrave 578 datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”¹². Drejtoria e Shërbimit Social ka ngritur grupin teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijës në nivel bashkie. Grupi teknik ndërsektorial ka në përbërje përfaqësues të strukturave të policisë, strukturave të shërbimeve sociale, përfaqësues të strukturave arsimore, shëndetësore, të drejtësisë, të organizatave jofitimprurëse, si dhe çdo specialist tjetër që ka njohuri për situatën e fëmijës ose që mund të kontribuojë në marrjen apo zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijës, të cilët janë të detyruar të marrin pjesë në mbledhjet e grupit teknik ndërsektorial. Për menaxhimin e rasteve Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës koordinon me punonjësin social të NJVNR.

Menaxhimi i rasteve të viktimave të dhunës në familje kryhet në përputhje me parashikimet në Vendimin e Këshillit të Ministrave 327 datë 2.06.2021 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare si dhe procedimin e tij për mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës”¹³. Koordinator i vendor për masa kundër dhunës në familje drejton ekipin teknik ndërdisiplinor (me përfaqësues të institucioneve të përcaktuara nga Komiteti Drejtues në nivelin vendor). Për menaxhimin e rasteve ndërvepron gjithashtu me punonjësin social të NJVNR dhe administratorët shoqëror sipas vendbanimit të viktimës së dhunës në familje. Për çdo rast tjetër të referuar në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje menaxhimi i rastit kryhet nga punonjësi social i NJVNR dhe administratorët shoqëror. Për çdo rast që në përputhje me Planin Individual të Mbrojtjes është vlerësuar se duhet të marrë shërbime kujdesi shoqëror menaxheri i rastit do të përgatisë dokumentacionin

¹² <http://differentandequal.org/ep-content/uploads/2019/09/VKM-nr.-578-dt-3.10.2018.pdf>

¹³ <https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2021/07/VKM-Nr.-327-dat%C3%AB-2.06-00000002.pdf>

përkatës në përputhje me VKM nr. 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar” dhe do ta referojë tek koordinatori për shërbimet sociale në Drejtorinë e Shërbimit Social në Bashki. Ky i fundit në përputhje me VKM e sipërcituar ndërmerr procedurat për miratimin e marrjes së shërbimit.

Objekti 7. Informim i komunitetit mbi egzistencën e sistemit komunitar të shërbimeve dhe ndërgjegjësim komunitar për të drejtat e çdo individi për të marrë shërbim

Aktivitetet:

2.7.1 Informim mbi sistemin e shërbimeve sociale dhe të drejtat e fëmijëve

Informimi i komunitetit mbi egzistencën e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror do të jetë prioritet i cili do të mundësohet përmes takimeve të drejtpërdrejta në territorin e Bashkisë. Këto takime do të shërbejnë gjithashtu edhe informimit mbi të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës në Bashki do të përgatisë çdo fillim viti, në konsultim me aktorët e përfshirë në grupet teknike ndërsektoriale, kalendarin e takimeve në shkollë dhe në komunitet me qëllim ndërgjegjësimin mbi të drejtat e fëmijëve, si dhe informimin e tyre e të fëmijëve mbi ku dhe si të referojnë rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje. Zbatimi do të përfshijë Njësinë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, kryetarët e fshatrave dhe përfaqësuesit e institucioneve dhe organizatave pjesë e mekanizmit lokal.

2.7.2 Ndërgjegjësim komunitar për të parandaluar dhe luftuar dhunën në familje, si dhe trafikimin e qënieve njerëzore

Takimet komunitare do të planifikohen në fillim të çdo viti nga koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në familje duke koordinuar me institucionet publike që kanë përgjegjësi në këtë fushë (pjesë e mekanizmit lokal të koordinuar për të adresuar dhunën në familje) ofruesit e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje, si dhe organizatat e shoqërisë civile që ushtrojnë aktivitet në këtë fushë. Në takimin planifikues të çdo viti do të ndërtohet kalendari vjetor i takimeve komunitare, do të përcaktohet audienca, çështjet që do të prezantohen dhe roli i secilit aktor në takime. Në thelb takimet komunitare do të synojnë pjesëmarrjen e komunitetit, burra dhe gra, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për të parandaluar dhe denoncuar dhunën në familje, informuar mbi trafikimin e qënieve njerëzore, si dhe informimit mbi shërbimet që egzistojnë për viktimat e dhunës në familje dhe viktimave të trafikimit. Takime të tilla do të targetojnë edhe shkollat në territorin e Bashkisë.

2.7.3 Ndërgjegjësim komunitar mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

Takimet komunitare do të planifikohen në fillim të çdo viti nga Drejtoria e Shërbimit Social (koordinatori për fuqizim ekonomik) duke koordinuar me ofruesit publik dhe jopublik të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, si dhe organizatat e personave me aftësi të kufizuara në këtë Bashki. Në takime do të përcaktohen çështjet që do të prezantohen në këto takime, si dhe detaje të zhvillimit të tyre. Në thelb takimet komunitare do të synojnë pjesëmarrjen e komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, prindërit e tyre, pjesëtarë të komunitetit me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, si dhe shmanigjen e stereotipeve ndaj tyre. Takimet do të shërbejnë edhe informimit të komuniteteve mbi egzistencën e shërbimeve në territor apo jashtë tij për këto grupe.

MEKANIZMAT NDËRSEKTORIAL FUNKSIONAL 2024-2026

Fuqizim ekonomik	PAK	Te moshuarit	Viktimat e dhunes ne familje	Femijet	Persona me varësi nga droga
• Koordinator per fuqizim ekonomik Bashki • NJVNR • Zyra e punës • Formimi profesional • AZHBR • Bizneset • Organizata	• Specialisti PAK/Drejtori • NJVNR • Shendetesia • Arsimi • Zyra e Punes • Ofruesit e sherbimeve per PAK • Organizata	• Punonjesi social/Drejtori • NJVNR • Shendetësia • Kryetarët e fshatrave • Ofruesit e shërbimeve për të moshuarit • Organizata	• Koordinator vendor • NJVNR • Policia • Shëndetësia • Zyra e Punes • Formimi profesional • Ofruesit e shërbimeve • Organizata • Kryetarët e fshatrave	• NJMF • NJVNR • Policia • Arsimi • Shëndetësia • Formimi profesional • Ofruesit e shërbimeve • Organizata • Kryetarët e fshatrave	• Punonjësi social/drejtorja • NJVNR • Policia • Shëndetësia • Ofruesit e shërbimeve • Organizata • Kryetarët e fshatrave

Qëllimi 3. Sistemi i zgjeruar dhe i organizuar i shërbimeve të kujdesit shoqëror do të mundësojë zhvillim, rehabilitim, riintegrim, pavarësinë dhe përfshirjen shoqërore të individëve dhe familjeve që i kanë të nevojshme këto shërbime

Objektivi 1. Konsolidim i shërbimeve egzistuese dhe ngritje e shërbimeve sociale të reja që adresojnë me efektivitet nevojat e individëve në nevojë për këto shërbime në territorin e Bashkisë

Aktivitetet:

3.1.1 Ngritje e shërbimeve të reja dhe kalimi i Qendrës “Lira” në Qendër multifunkionale për personat me aftësi të kufizuara

Qendra “Lira”, e cila ka tashmë një shërbim të konsoliduar do të shërbëjë fëmijëve me aftësi të kufizuara, personave me aftësi të kufizuara në Bashkinë Berat, prindërve dhe familjarëve të tyre, duke zgjeruar shërbimet e nevojshme viti pas viti si pasojë e rritjes progresive të buxhetit dedikuar kësaj qëndre.

Financimi i rritur vit pas viti do të orientohet në: (i) përmirësimin e hapsirave të brendshme të qëndrës, duke i bërë ato të vlefshme për tu përdorur sipas zgjerimit të aktivitetit të qëndrës me shërbime plotësuese. (ii) rritjen e numrit të specialistëve që ofrojnë shërbime të specializuara për personat me aftësi të kufizuara si dhe në ngritjen në vazhdimësi të kapaciteteve profesionale të stafit në qendër. Bashkia Berat në afatet e përcaktuara nga ky plan do të ndërhyjë në këto drejtime: (a) Shtimi i numrit të stafit të qendrës (b) vazhdimi i mbulimit të 100% shpenzimeve të qëndrës; (c) akordimi i fondit për përmirësimin e hapësirave të brendshme të qendrës; (d) realizimi i trajnimeve të vazhdueshme për përgatitjen e stafit profesional të qendrës.

Qendra do të ofrojë tipe të ndryshme shërbimesh sipas nevojave të personave me aftësi të kufizuara. Shërbimet e kësaj Qendre do të adresojnë nevojat e : (i) personave me aftësi të kufizuara të grupmoshës mbi 21 vjeç nga gjithë territori i Bashkisë dhe (ii) fëmijëve me aftësi të kufizuara. Shërbimet do të ofrohen nga një ekip profesionistësh (kryesisht punonjës social, fizioterapist, logopedist, psikolog dhe okupacionist), në përputhje me standartet kombëtare për këtë tip shërbimi kujdesi shoqëror. Gjatë vitit të parë të zbatimit të Planit qendra do të vijojë të ofrojë të gjitha shërbimet që ofron aktualisht për këto grupe duke priorizuar: (i) për fëmijët terapi zhvilluese dhe rehabilituese, si dhe shërbime të ndërhyrjes së herëshme (duke zhvilluar më tej partneritetin me strukturat e shëndetësisë dhe arsimit); (ii) për të rinjtë me aftësi të kufizuara, përveç terapive sipas nevojës edhe formim profesional dhe orientim drejt punësimit (për format përkatëse të aftësisë së kufizuar dhe duke thelluar partneritetin me Zyrën e Punës dhe qendra formimi profesional).

Në vitin e parë gjithashtu pranë qendrës do të ngrihet programi i mbështetjes së ndihmës personal të personit me aftësi të kufizuara. Ekipi i profesionistëve do të këshillojë, orientojë, trajnojë edhe prindërit/familjarët/ndihmësit e personave me aftësi të kufizuara për të përmirësuar cilësinë e shërbimit dhe jetesës së personave me aftësi të kufizuara në mjedisin familjar dhe në komunitet.

Që nga vitit i dytë i zbatimit të Planit Qendra do të ofrojë edhe shërbim në familje për personat me aftësi të kufizuara që e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare, që nuk

mund të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari/ndihmësi personal. Shërbimi në shtëpi do të ngrihet në përputhje me standartin kombëtar për këtë formë shërbimi dhe do të përfshijë: (i) shërbime rehabilitimi, zhvillimi, këshillim psikologjik e ligjor sipas rastit; (ii). shpërndarjen e ushqimeve të gatshme në shtëpi (sipas nevojës); (iii) dhënien e medikamenteve sipas recetës së mjekut apo shërbime të tjera të kujdesit të shëndetit; Një mjet transporti i përshtatur do të jetë në funksion të qendrës si për sigurimin e aksesit në shërbim të personave me aftësi të kufizuara që jetojnë jashtë Beratit, ashtu edhe lëvizjen e stafit të qendrës për të ofruar shërbim në familje sipas nevojave të vlerësuara dhe vendimit të Bashkisë Berat. Nga viti i tretë i zbatimit të këtij Plani Qendra do të shërbej për informimin, orientimin dhe këshillimin e personave me aftësi të kufizuara, si dhe advokacie për të drejtat e tyre. Kjo formë shërbimi do të ofrohet nga vetë personat me aftësi të kufizuara të trainuar dhe të punësuar pranë saj. Qendra përmes informimit, orientimit, ndërmjetësimit do të lehtësojë aksesin e personave me aftësi të kufizuara tek shërbime të tjera të nevojshme si: strehimi, punësimi, transporti, aktivitete shlodhese, akses në shërbimet sociale e shëndetësore.

3.1.2 Zgjerim i partneriteteve në Qendrën “Unë jam si ju”, përmirësim i infrastrukturës egzistuese, zgjerim i shërbimeve egzistuese

Prioritetet për periudhën tre vjeçare të zbatimit të këtij Plani për Qendrën “Unë jam si ju” do të jenë:

1. Zgjerimi i partneritetit

Qendra ka bashkëpunim të mirë me institucionet shëndetësore, por duhet të zhvillojë partneritetin me institucionet arsimore (për grup moshën shkollore), si dhe me qendrën e formimit profesional. Kjo e fundit për të adresuar mungesën e kurseve të formimit profesional të cilat duhet të shërbejnë për të ndihmuar rehabilitimin e këtyre personave. Ngritja e mekanizmit për personat me aftësi të kufizuara dhe përfshirja e kësaj qendre në diskutimet në tryezat e organizuara nga Drejtoria e Shërbimit Social do të lehtësojë këtë proces zgjerimi partneriteti dhe veprimeve konkrete të ndërmarra bashkë me institucionet e specifikuar më lart.

2. Investimi për përmirësimin e infrastrukturës ndërtimore dhe pajisjeve

Ndërrhyrja me investime do të mbështesë punën e stafit për të zbatuar dhe respektuar standardet e shërbimit në këtë qendër, në përputhje me kriteret kombëtare.

3. Trajnimi i vazhdueshëm i stafit

Trajnimi në vazhdimësi i stafit të qendrës duhet të fokusohet si në zbatimin e standardeve të shërbimeve ashtu edhe në punën direkte që duhet të bëjnë me personat me aftësi të kufizuara në qendër. Për realizimin e trajnimeve qendra do të ndërveprojë me Drejtorinë e Shërbimit Social në Bashki. Nevojat për trajnim do të jenë pjesë e planit të trajnimeve vjetore të hartuar dhe ndjekur për zbatim nga kjo drejtori.

4. Intensifikim i punës për kthimin në familje të personave me aftësi të kufizuara, rezident prej vitesh në qendër

Kjo do të kërkojë ndërveprim të stafit të qendrës me drejtorinë rajonale të SHSSH Berat me qëllim lehtësimin e komunikimit dhe shkëmbim informacioni me Bashkitë nga e kanë gjendjen civile personat që marrin shërbim në qendër.

3.1.3 Zgjerimi i shërbimeve në qendrën egzistuese komunitare

Qendra multifunkionale e Bashkisë e ngritur me mbështetjen e UNDP do të vijojë të ofrojë shërbimet e klasave mbështetëse, këshillimit psikologjik dhe organizimit të aktiviteteve. Qendra do të ketë gjithashtu prioritet zbatimin e një Programi riintegrimi për familje në nevojë të komunitetit rom/egjiptian. Përveçse integrimi i pjesëtarëve të komunitetit rom në shërbimet që ofron qendra do të jetë prioritet, sipas nevojave të vlerësuara për shërbime, qendra do të ketë një njësi lëvizëse që do të punojë në terren për të identifikuar nevojat për shërbime të pjesëtarëve të këtij komuniteti dhe referimin apo ndërmjetësimin për marrjen e shërbimeve. Të paktën një punonjës social (pjesëtar i kësaj njësie) do të jetë pjesë e komuniteti rom/egjiptian.

3.1.4 Ngritja e Qendrës Multifunkionale Rajoni 3

Qendra do të funksionojë që nga viti i dytë i zbatimit të këtij plani dhe në të do të ofrohen shërbime sipas nevojave për shërbime të familjeve/individëve të vlerësuar nga Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit dhe miratuar nga Drejtoria e Shërbimit Social. Në këtë qendër do të ngrihen gjithashtu tre shërbime të specializuara që do të mbulojnë nevojat për gjithë territorin e Bashkisë. Shërbimet do të ofrohen nga stafi i përbërë nga : punonjës social (2), psikolog (2), jurist (1), edukator shkollor (1).

Shërbimet që do të ofrohen në këtë qendër nga stafi i profesionistëve do të përfshijnë:

Shërbimet për fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje: përgatitja për mësim, aktivitete sociale dhe argëtuese për fëmijë të moshës 7-15 vjeç, vakt ushqimor;

Shërbime psikosociale, do të ofrohen për (i) fëmijë viktimë të dhunës/trafikimit/abuzimit (ii) Viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit (iii) familje që kanë përjetuar divorc.

Këshillim dhe asistencë ligjore do të ofrohet në mënyrë të veçantë viktimave të dhunës në familje, fëmijëve në konflikt me ligjin, viktimave të trafikimit, personave me aftësi të kufizuara, familjeve që kanë përjetuar divorc.

Shërbime të emergjencës. Pakot ushqimore dhe kitet higjienike do të shërbejnë qëndrës për të mbështetur në mënyrë të menjëherëshme nevojat e familjeve/individëve të identifikuar në situatë emergjence sipas vlerësimit të kryer nga Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit.

Shërbim i lëvizshëm për zonën rurale të Bashkisë

Qendra do të ndërveprojë me Qendrën Lira për të patur akses në mjetin e transportit të nevojshëm për të mundësuar lëvizjen e profesionistëve në zonën rurale. Rastet në nevojë për shërbime do të vlerësohen e referohen nga Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit.

Shërbime të specializuara që përmbushin nevojat për të gjithë territorin e Bashkisë:

Programi i përgatitjes së familjeve kujdestare, do të përmbushë një nga detyrimet që rrjedhin nga Vendimi i Këshillit të Ministrave mbi shërbimin e kujdesit alternativ për fëmijë pa kujdes prindëror. Çdo familje e identifikuar si familje e mundshme kujdestare apo familje që ka fëmijë në përkujdesje, do të përfshihet në këtë program dhe do të përfitojë kurse prindërimi, sikurse mbështetje sipas nevojave të vlerësuara. Ky shërbim do të mbulojë nevojat për gjithë territorin e Bashkisë.

Program i rehabilitimit për viktimat e abuzimit seksual. Do të ofrohet për viktimat e abuzimit seksual kur është vlerësuar se jeta në familje do të vijojë pa ndërprerje. Programi do të

përfshijë terapistë për rehabilitim shëndetësor e psikologjik dhe çdo nevojë tjetër e identifikuar për viktimën e abuzimit seksual të tilla si asistencë juridike apo shërbime riintegruese.

Shërbim rehabilitimi për personat me varësi nga droga/alkooli në nivel komunitar

Për çdo rast të identifikuar do të kryhet një vlerësim i nevojave për shërbime shëndetësore dhe sociale, pra punonjësi social i NjVNR do të ndërveprojë me mjekun e familjes/qendrës shëndetësore për të ndërtuar planin e mbështetjes me shërbime. Përgjatë tre viteve të zbatimit të Planit çdo individ me këto nevoja do të mbështetet me shërbim shëndetësor dhe rehabilitim psikosocial. Shërbimi psikosocial do të jetë i kombinuar me Qendrën Multifunkionale, sipas nevojave të vlerësuara të çdo individ do të referohen rastet edhe tek shërbime të tjera (punësimi, strehimi, formimi profesional etj). Kjo formë shërbimi do të hedhë bazat për të vijuar pas vitit 2023 me shërbime okupacionale komunitare për këto grupe.

3.1.5 Shërbimi i këshillimit me telefon

Për fëmijët: Drejtoria e Shërbimit Social do të ndërtoj partneritetin me Linjën Kombëtare për Fëmijë “Alo 116 111” me qëllim që linja telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, të ofroj mbështetje, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje apo përkujdesje.

Për viktimat e dhunës në familje: Drejtoria e Shërbimit Social do të ndërtoj partneritetin me Linjën Kombëtare të Këshillimit për Viktimat e Dhunës në Familje me qëllim që linja telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, të ofroj mbështetje, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës në familje.

3.1.6 Shërbimi i strehimit social

Bashkia do të vijoj të mbështesë grupet në nevojë të identifikuar në këtë plan Social përmes aplikimit të tre programeve:

1. Bonus i qerasë për familje me të ardhura të pamjaftueshme çdo vit.
2. Banesa sociale.
3. Rikonstruktion banese për familjet rome/egjiptiane

Përmes këtyre programeve Bashkia do të trajtojë çdo vit me prioritet familje që kanë pamundësi për të përballuar koston e strehimit dhe në mënyrë të veçantë: Familje përfituese të ndihmës ekonomike që kanë grua kryefamiljare; Familje përfituese të ndihmës ekonomike që kanë fëmijë të mitur; Familje rome/egjiptiane; Familje përfituese të ndihmës ekonomike që kanë të paktën një pjestar me aftësi të kufizuara; Viktima të dhunës në familje; Viktima të trafikimit; Persona me aftësi të kufizuara; Të moshuar.

3.1.7 Shërbim i strehimit të mbrojtur për viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit

Ky shërbim do të ofrohet viktimave të dhunës në familje dhe viktimave të trafikimit të grupmoshës mbi 18 vjeç që nuk kanë një strehë. Ai do të organizohet në formën e banesave individuale. Dy apartamente do të merren me qera dhe do të shërbejnë si struktura akomoduese tranzitore për këto dy grupe dhe do të mundësojnë siguri dhe mbështetje për jetesë brenda dhe jashtë ambientit të banimit. Akomodimi në këto banesa i viktimës së dhunës në familje apo viktimës së trafikimit do të shoqërohet me përfshirjen në shërbime të tjera komunitare: ushqim në rast se viktima nuk ka të ardhura, kujdes shëndetësor, trajtim psikologjik dhe emocional,

këshillim dhe referim tek shërbimet rehabilituese dhe riintegruese në tregun e punës për viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit, shërbimet e strehimit social në përputhje me vlerësimin e kryer për nevojat e tyre.

3.1.8 Shërbim i emergjencës 72 orë për viktimat të dhunës në familje

Ky shërbim do të vijojë të funksionojë në periudhën tre vjeçare të zbatimit të këtij Plani. Përgjatë zbatimit të këtij Plani shërbimi do të mundësojë akomodimin, ushqimin dhe mjedis të mbrojtur për 72 orë derisa viktimës ti mundësohen shërbime të tjera sipas nevojës. Gjatë menaxhimit të këtyre rasteve koordinatori vendor për masa kundër dhunës në familje do të ndërveprojë sipas nevojave të identifikuar të çdo rasti me shërbimet e Qendrës Multifunkionale Komunitare Rajoni 3 (për ushqimin, paketat higjienike, shërbimin psikologjik), shërbimin e strehimit social, sikurse do të përfshijë viktimat e dhunës në programet e fuqizimit ekonomik.

3.1.9 Shërbim në qendër ditore dhe i asistencës në familje për të moshuarit

Qendra ditore që funksionon në partneritet me Kryqin e Kuq do të zgjerojë aktivitetin e saj egzistues ditor për të moshurit me këto shërbime shtesë:


Shërbim asistencë shtëpiake për të moshuarit. Ky shërbim do të ngrihet në përputhje me standartin kombëtar për këtë formë shërbimi dhe do ti ofrohet të moshuarve që kanë humbje të autonomisë së tyre. Kjo formë shërbimi do të kërkojë ndër të tjera vlerësimin e kushteve në shtëpi, përgatitjen e planeve të kujdesit në shtëpi dhe mbështetja, aty ku është e nevojshme, e kujdestarëve me instruksione për shërbime të specializuara, si: ndërrimi i kateterit, trajtimi i plagëve kronike etj.

Mbështetje për kujdestarin e të moshuarit/ës. Anëtarët e familjes që luajnë rolin e kujdestarëve për të moshuarit e sëmurë do të mbështeten në formën e edukimit/informimit, këshillimit psikologjik, lehtësimit të komunikimit me institucionet dhe formalizimit të tyre në tregun e punës.

Për ngritjen e këtij shërbimi Drejtoria e Shërbimit Social do të ndërveprojë me Zyrën e Punës për të mundësuar financimin e shërbimit përmes programit të punës në komunitet. Stafit egzistues të Kryqit të Kuq do ti bashkohet një punonjës social që do të drejtojë si programin e asistencës në familje për të moshuarit ashtu edhe programin e mbështetjes për kujdestarin e të moshuarit/ës/. Personeli i nevojshëm për shërbimin e asistencës në shtëpi do të financohet nga programi i punës në komunitet. Rastet që kanë këto nevoja do të identifikohen nga NJVNR. Shërbimi do të ngrihet duke nisur nga viti i dytë i zbatimit të këtij Plani për zonën urbane. Në zonën rurale zgjerimi do të ndodhi në vitin e tretë, duke ndërvepruar me Qendrën Multifunkionale të PAK (“Lira”) për mundësimin e mjetit të transportit.

3.1.10 Shërbim i strehimit të mbrojtur për persona me aftësi të kufizuara

Ky shërbim do të pilotohet duke nisur nga viti i tretë i zbatimit të këtij plani. Ai do të ngrihet për persona me probleme të shëndetit mendor që nuk kanë banesë dhe familje. Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit do të vlerësoj 4-5 raste të mundshme për tu përfshirë në këtë shërbim dhe vlerësimin përfundimtar do ta kryej stafi multifunksional i Qendrës “Lira”. Ky i fundit do të ndërveprojë vazhdimisht me 2 punonjës të atashuar pranë apartamentit ku jetojnë personat me aftësi të kufizuar, që i mbështesin ata në përditshmërinë e jetës së tyre dhe ndërveprimin me institucionet, komunitetin jashtë shtëpisë.



Qëllimi 4. Sistemi komunitar i shërbimeve të kujdesit shoqëror përmbush standartet kombëtare të cilësisë dhe përshtatshmërisë dhe mban në konsideratë këndvështrimin e komunitetit

Objektivi 1: Sistemi komunitar i shërbimeve do të përgjigjet cilësisht nevojave në ndryshim të grupeve vulnerabël

Aktivitetet:

4.1.1 Monitorimi i cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve

Çdo shërbim që do të ngrihet dhe funksionojë në territorin e Bashkisë me fondet e saj do të monitorohet nga Drejtoria e Shërbimit Social. Me mbështetjen e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Berat specialisti për monitorimin e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve të kësaj drejtorie do të zhvillojë instrumentat e monitorimit të çdo shërbimi bazuar në standartet kombëtare të shërbimit specifik. Pjesë e procesit të monitorimit do të jenë edhe intervistat/fokus grupet që do të zhvillohen me përfituesit e shërbimeve. Konkluzionet e çdo monitorimi do të lehtësojnë përmirësimin e cilësisë dhe përshtatshmërinë e shërbimeve që ofrohen.

Objektivi 2: Përfshirje e komunitetit në vendimarrjet që lidhen me sistemin komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror

Aktivitetet

4.2.1 Rishikimi periodik i Planit Social

Edhe pse Plani i hartuar është tre vjeçar, për shkak të gjendjes në ndryshim të grupeve vulnerabël, por edhe aftësisë së Bashkisë për të thithur fonde e mundësuar financimin e komponentëve të Planit që janë parashikuar të zbatohen me financim jashtë Bashkisë, është i nevojshëm rishikimi i tij çdo vit. Për të mundësuar rishikimin e Planit Social drejtoria e shërbimit social do të mbledhë dhe analizojë në mënyrë periodike treguesit socialë statistikorë dhe administrativë, si dhe të dhënat mbi shërbimet egzistuese. Përveç analizës së treguesve sociale kjo drejtori do të zhvillojë dëgjesa me grupet që preken nga zbatimi i Planit dhe në mënyrë të veçantë me: fëmijët, gratë, viktimat e dhunës në familje, përfaqësues të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, komuniteti rom/egjiptian. Dëgjesat do të shërbejnë identifikimit të nevojave për shërbime në këndvështrimin e vetë atyre që i kanë të nevojshme ato. Takime konsultuese do të zhvillohen dhe me institucionet që janë të përfshira në grupet teknike ndërsektoriale për të vlerësuar mundësinë e përmirësimeve të mëtejshme në punën për grupet vulnerabël në territorin e Bashkisë.

4.2.2 Zëri i përfituesve të shërbimeve dhe komunitetit

Në faqen elektronike të Bashkisë do të krijohet një hapësirë për ti dhënë mundësinë komunitetit të japin këndvështrimin e tyre si mbi shërbimet egzistuese, ashtu edhe shërbimet e reja që në këndvështrimin e tyre janë të nevojshme. Në çdo qendër perkujdesi (edhe në përputhje me standartet kombëtare) do të ketë një kuti për tu dhënë mundësi përfituesve të shërbimit të shprehin këndvështrimin e tyre mbi shërbimin dhe si mund të plotësohet apo përmirësohet ai. Aksesin për të marrë këto mendime do ta ketë vetëm Drejtoria e Shërbimit Social të Bashkisë.

7. PLANI I VEPRIMIT

QËLLIMI 1: ZHVILLIMI I MËTEJSHËM I KAPACITETEVE, INFRASTRUKTURËS DHE BURIMEVE FINANCIARE TË BASHKISË PËR T'JU PËRGJIGJUR CILËSISHT ME SHËRBIME SOCIALE NEVOJAVE TË KOMUNITETIT

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	BURIMI I TË DHËNAVE	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO TRE VITE
<i>Objektivi 1. Personeli përgjegjës për shërbimet sociale në të gjitha nivelet e organizimit do të jetë i përgatitur dhe ka burimet e nevojshme për të përmbushur cilësisht funksionet e tyre ligjore</i>						
1.1.4 Riorganizim i Drejtorisë së Shërbimit Social në perputhje me parashikimet ligjore	Drejtoria e shërbimit social Drejtoria e burimeve njerëzore	Shkurt – Mars 2024	Drejtoria e organizuar në numër dhe funksione sipas parashikimeve ligjore; Rregullorja e Bashkisë përmban përshkrim të ri pune për Drejtorinë dhe çdo specialisti sipas parashikimeve ligjore;	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetëqeverisjen vendore Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare” Ligji "Për asistencën sociale"	Bashkia	17,791,200

				Ligji “Për barazinë gjinore” Ligji “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë”		
1.1.5 Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit	Drejtoria e Shërbimit Social Drejtoria e Burimeve Njerëzore	Prill-Maj 2024	NJVNR e organizuar në numër dhe funksione sipas parashikimeve ligjore; Rregullorja e Bashkisë përmban përshkrim të ri pune për NJVNR dhe çdo specialisti sipas parashikimeve ligjore;	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetëqeverisjen vendore Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare” Ligji "Për asistencën sociale" Ligji “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë”	Bashkia	38,594,400
1.1.6 Sistemi publik lokal i shërbimeve sociale	Drejtoria e Shërbimit Social Drejtoria e Burimeve Njerëzore	Shkurt-Mars 2024	Rishikuar strukturat e varësisë së Drejtorisë së Shërbimit Social;	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”	Bashkia	0

			Ndryshimet janë reflektuar në rregulloren e brendëshme të Bashkisë	Ligji “Për vetëqeverisjen vendore		
1.1.4 Përgatitja e stafëve për t’ju përgjigjur cilësisht detyrave sipas pozicionit	Drejtoria e shërbimit social	Qershor – Dhjetor 2024 2025 2026	Numri i trainimeve të zhvilluara në përputhje me fushat e identifikuara për ngritje kapacitetesh; Numri i pjesëmarrësve në trainim në përputhje me rolin dhe funksionin që kanë; Praktika pune të përmirësuara në vijim të trainimeve si rezultat i kapaciteteve të rritura dhe shprehive të fituara nga trainimet;	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetqeverisjen vendore” Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare” Ligji "për asistencën sociale" Ligji “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë” Ligji "Për të drejtën e informimit publik" Ligji "Për prokurimin Publik"	Bashkia	900,000

1.1.5 Garantimi i infrastrukturës dhe mjeteve të përshtatëshme të punës për të gjitha strukturat	Drejtoria e Shërbimit Social	Qershor-Dhjetor 2024 2025	Deri në fund të vitit të parë të zbatimit të planit nevojat për përmirësime në infrastrukturë dhe mjete pune për NJVNR janë identifikuar; Buxheti i Bashkisë ka përfshirë nevojat e NJVNR Drejtoria e shërbimit sot ka përgatitur udhëzime/praktika pune për personelin e NJVNR	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetqeverisjen vendore”	Bashkia	0
1.1.6 Thithja e fondeve	Drejtoria e shërbimit social Specialisti për monitorimin e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve në bashkëpunim me njësinë e projekteve në Bashki	2024 2025 2026	Projekt-propozime të hartuara në përputhje me parashikimet e Planit Social Deri në fund të vitit 2026 komponentët e planit janë zbatuar përmes Fondit Social të ngritur	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetqeverisjen vendore”	Bashkia	0

QËLLIMI 2. KONSOLIDIM I MEKANIZMAVE NDËRSEKTORIAL EGZISTUES DHE ZGJERIM ME MEKANIZMA TË RINJ PËR IDENTIFIKIM DHE ADRESIM EFEKTIV TË NEVOJAVE TË GRUPEVE VULNERABËL

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	REFERENCA LIGJORE	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO
Objekti 1: Zgjerim i mekanizmit dhe ndëveprimit për të mundësuar riintegrim ekonomik e social të individëve në situatë vulnerabël						

2.1.1 Zgjerim i mekanizmit egzistues për fuqizimin dhe riintegrimin ekonomik e social	Drejtoria e Shërbimit Social Koordinatori për fuqizimin ekonomik	2024 2025 2026	Mekanizmi i institucionalizuar mes tre institucioneve Numri i individëve nga familjet përfituese të ndihmës ekonomike për të cilët janë përgatitur Planet Individuale të Veprimit Numri i individëve të të dy gjinive që kanë arritur të përfitojnë nga shërbimet e formimit profesional dhe punësimit çdo vit. Numri i nënave kryefamiljare, pjesëtarëve të komunitetit rom/egjiptian, personave me aftësi të kufizuara, viktimave të dhunës dhe trafikimit që kanë arritur të punësohen çdo vit. Numri i familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike që kanë lënë skemën e ndihmës për shkak të arritjes së fuqizimit ekonomik.	Ligji “Për asistencën sociale” Ligji “Për nxitjen e Punësimit” Vendim nr. 882, datë 24.12.2019 “Për mekanizmin e bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike” Urdhëri i Përbashkët i Ministres së Financës dhe Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbi Protokollin e Bashkëpunimit mes SHSSH dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit (gusht 2019)	Bashkia Partneritet me Zyrën e Punës, AZHBR	0
---	--	-------------------------------	--	---	---	----------

2.1.2 Këshillimi për punësim dhe ofertat e punës	Drejtoria e Shërbimit Social NJVNR Zyra e Punës	2024 2025 2026	Numri i individëve nga familjet përfituese të ndihmës ekonomike për të cilët janë përgatitur Planet Individuale të Veprimit Numri i individëve të të dy gjinive që kanë arritur të përfitojnë nga shërbimet e formimit profesional dhe punësimit çdo vit. Numri i nënave kryefamiljare, pjesëtarëve të komunitetit rom/egjiptian, personave me aftësi të kufizuara, viktimave të dhunës dhe trafikimit që kanë arritur të punësohen çdo vit.	Ligji “Për asistencën sociale” Vendim nr. 882, datë 24.12.2019 “Për mekanizmin e bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike”	Bashkia në partneritet me Zyrën e Punës	0
2.1.3 Masa të Bashkisë për fuqizimin ekonomik	Drejtoria e Shërbimit Social Koordinatori i fuqizimit ekonomik	2024 2025 2026	Analiza e tregut të punës mundëson listin e profesioneve në territor Kurset e formimit profesional orientohen sipas listës së profesioneve Numri i të rinjve nga familje në situatë të vështirë ekonomike të punësuar nga programi i Bashkisë; Numri i kontratave për punë publike të Bashkisë	Ligji “Për vetqeverisjen vendore” Ligji “Për asistencën sociale”	Bashkia	1,404,000

			Numri i të papunëve afatgjatë në grupmoshat 45-64 vjeç, të të dy gjinive, që janë punësuar përmes kontratave publike.			
Objektivi 2. Ngritje e mekanizmit të koordinuar për adresimin efektiv të nevojave të personave me aftësi të kufizuara						
2.2.4 Ngritja dhe funksionimi i mekanizmit	Drejtoria e shërbimit social Në partneritet me strukturat e arsimit, shëndetësisë, zyrën e punës dhe ofruesit e shërbimeve	2024 2025 2026	Tryeza me përfaqësues të institucioneve e zhvilluar në përputhje me objektivat e parashikuara; Rrjeti i specialistëve nga secili institucion që do të angazhohet në vijim i ngritur dhe funksional.	Ligji "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara"	Bashkia	0
2.2.2 Identifikimi i rasteve në nevojë për shërbime	Drejtoria e shërbimit social Në partneritet me strukturat e arsimit, shëndetësisë, zyrën e punës dhe ofruesit e shërbimeve	2024 2025 2026	Numri i rasteve të identifikuar nga secila strukturë Numri i fëmijësve me aftësi të kufizuara të përfshirë në shërbimet e ndërhyrjes së herëshme	Ligji "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara"		0
2.2.3 Rritja e aksesit të personave me aftësi të kufizuara në mjedisin publik dhe në shërbime	Drejtoria e shërbimit social Në partneritet me drejtoritë në bashki (transportë, urbanistikë dhe financë)	2025	Raporti identifikon qartësisht ndërhyrjet që duhet të kryej çdo institucion publik, përfshirë Bashkinë, për të mundur respektimin e legjislacionit dhe Konventës Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësisë të Kufizuara.	Ligji "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara"	Bashkia	0

			Në mënyrë të veçantë identifikohen qartësisht godinat dhe mjediset ku duhet të ndërhyhet për ti bërë të aksesueshme. Investime të ndërmarra nga Bashkia apo sugjeruar aktorëve të tjerë publik me qëllim garantimin e aksesit të personave me aftësi të kufizuara në mjedise publike.			
Objektivi 3. Ngritje dhe funksionim i mekanizmit për veprim të koordinuar për adresimin e nevojave të të moshuarve						
2.3.1. Krijimi i strukturave koordinuese për mbështetjen e të moshuarve	Drejtoria e shërbimit social në partneritet me strukturat e shëndetësisë, ofruesit e shërbimeve, organizatat joqeveritare	2024	Tryeza me përfaqësues të institucioneve e zhvilluar në përputhje me objektivat e parashikuara; Rrjeti i specialistëve nga secili institucion që do të angazhohet në vijim i ngritur dhe funksional.	Vendim nr.864,datë 24.12.2019 “Për miratimin e dokumentit politik kombëtar për moshimin, 2020–2024,dhe të planit të veprimit për zbatimin e tij”	Bashkia në partneritet me strukturat e shëndetësisë, ofruesit e shërbimit, organizata joqeveritare	0
2.3.2 Rritja e aksesit të të moshuarve në transportin publik	Drejtoria e shërbimit social në partneritet me strukturat përgjegjëse të transportit publik në Bashki	2025	Raporti përmban rekomandime për rritjen e aksesit të të moshuarve në nevojë në transportin publik; Miratimi i masave të propozuara në këshillin Bashkia;	Vendim nr.864,datë 24.12.2019 “Për miratimin e dokumentit politik kombëtar për moshimin, 2020–2024,dhe të planit të veprimit për zbatimin e tij”	Bashkia	0

			Numri i të moshaurve në nevojë që përfitojnë nga kjo formë shërbimi;			
Objektivi 4. Ngritje e mekanizmit lokal për veprim të koordinuar për reabilitimin e përdoruesve të drogës						
2.4.1. Krijimi i strukturave koordinuese për identifikimin e rasteve	Drejtoria e shërbimit social në partneritet me strukturat e shëndetësisë, ofruesit e shërbimeve, organizatat joqeveritare Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit	2024	Takimi mes institucioneve ngre rrjetin e referimit të rasteve; Numri i rasteve të referuara pranë NJVNR nga strukturat e shëndetësisë dhe policisë; Numri i rasteve të referuara pranë secilës prej NJVNR nga anëtarët e mekanizmit;	Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror"	Bashkia në partneritet me strukturat e shëndetësisë, policisë dhe ofruesit e shërbimeve	0
Objektivi 5: Konsolidim i mekanizmave egzistues për identifikimin, mbrojtjen dhe reabilitimin e fëmijëve dhe viktimave të dhunës në familje						
2.5.1. Konsolidimi i punës së grupeve teknike ndërsektoriale për mbrojtjen dhe kujdesin ndaj fëmijëve	NJMF	Qershor dhe dhjetor i çdo viti 2024 2025 2026	Plani i Veprimit i përgatitur çdo vit; GTN mblidhet dhe menaxhon rastet sipas parashikimeve ligjore; Numri i rasteve të menaxhuara;	Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" Ligji "Për vetqeverisjen vendore" Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"	Bashkia	0
2.5.2. Konsolidimi i mekanizmit vendor për parandalimin e dhunës në familje dhe adresimin e nevojave të viktimave të saj	Koordinatori vendor për masa kundër dhunës në familje	Qershor dhe dhjetor i çdo viti 2024 2025	Komiteti drejtues mblidhet dhe analizon situatën sipas parashikimeve ligjore; Grupet e ETN mblidhen sipas rasteve të referuara;	Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"	Bashkia	0

		2026	Numri i rasteve të menaxhuara; Analiza mbi situatën e dhunës në familje dhe adresimin e nevojave të viktimave;	Ligji “Për vetqeverisjen vendore” Ligji “Per masa kunder dhunes ne marredheniet familjare”		
Objektivi 6. Identifikim proaktiv dhe menaxhim efektiv i çdo rasti në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje						
2.6.3 Ngritja e sistemit të integruar të referimit të rastit	Drejtoria e shërbimit social	Qershor - Gusht 2024	Ngritja e sistemit të referimit të rastit duke përfshirë në të çdo institucion publik, ofrues shërbimesh dhe organizata që janë të angazhuara në këtë fushë. Sistemi i referimit i publikuar në faqen elektronike të Bashkisë.	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetëqeverisjen vendore Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare” Ligji "Për asistencën sociale" Ligji “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë”	Bashkia	166,400

2.6.4 Menaxhim efektiv i rasteve dhe referimi tek shërbimet e kujdesit shoqëror	Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit	2024 2025 2026	Numri i rasteve të referuara pranë NJVNR Numri i rasteve të menaxhuara për secilin prej grupeve të targetuara nga Plan Social apo cdo individ tjetër në nevojë për shërbime;	Ligji "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara" Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror"	Bashkia	5,781,000
Objektivi 7. Informim i komunitetit mbi egzistencën e sistemit komunitar të shërbimeve dhe ndërgjegjësim komunitar për të drejtat e çdo individi për të marrë shërbim						
2.7.4 Informim mbi sistemin e shërbimeve sociale dhe të drejtat e fëmijëve	Drejtoria e shërbimit social Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit	2024 2025 2026	Numri i takimeve komunitare të zhvilluara me qëllime të informimit komunitar; Numri i pjesëmarrësve të të dy gjinive të përfshirë në takime; Numri i takimeve në shkolla të zhvilluara me qëllime të informimit e ndërgjegjësim; Numri i fëmijëve dhe të rinjte të të dy gjinive të përfshirë në takime;	Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" Ligji "Për vetëqeverisjen vendore Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve" Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare" Ligji "Për asistencën sociale"	Bashkia në partneritet me institucione lokale, organizata joqeveritare dhe ofrues shërbimesh	360,000

				Ligji “Për barazinë gjinore” Ligji “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë” Ligji “Për të drejtën për informim”			
2.7.5	<i>Ndërgjegjësim komunitar për të parandaluar dhe luftuar dhunën në familje, si dhe trafikimin e qënieve njerëzore</i>	Drejtoria e shërbimit social Në partneritet me strukturat e arsimit, shëndetësisë, policia, zyrën e punës, ofruesit e shërbimeve, organizatat joqeveritare	2024 2025 2026	Takimet koordinuese të zhvilluara në përputhje me objektivat e parashikuara; Numri i takimeve komunitare dhe çështjet e prezantuara dhe të diskutuara në to. Numri i grave dhe vajzave, burrave dhe djemve të përfshirë në takimet informuese dhe ndërgjegjëse; Rritje e numrit të rasteve të raportuara të dhunës në familje nga komuniteti;	Ligji "Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare"	Bashkia në partneritet me strukturat e arsimit, shëndetësisë, policia, zyrën e punës, ofruesit e shërbimeve, organizatat joqeveritare	300,000
2.7.6	<i>Ndërgjegjësim komunitar mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara</i>	Drejtoria e shërbimit social Në partneritet me strukturat e arsimit, shëndetësisë, zyrën e punës dhe ofruesit e	2025 2026	Takimet koordinuese të zhvilluara në përputhje me objektivat e parashikuara;	Ligji "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara"	Bashkia në partneritet me strukturat e arsimit, shëndetësisë, zyrën e punës	300,000

	shërbimeve, organizatat joqeveritare		Numri i takimeve komunitare dhe çështjet e prezantuara dhe të diskutuara në to. Numri i personave me aftësi të kufizuara, prindërve, pjesëtarëve të komunitetit (burra dhe gra) pjesëmarrës në takimet informuese dhe ndërgjegjëse		dhe ofruesit e shërbimeve dhe organizatat joqeveritare	
--	---	--	--	--	---	--

**QËLLIMI 3. SISTEMI I ZGJERUAR DHE I ORGANIZUAR I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR DO TË MUNDËSOJË ZHVILLIM,
REABILITIM, RIINTEGRIM, PAVARËSINË DHE PËRFSHIRJEN SHOQËRORE TË INDIVIDËVE DHE FAMILJEVE QË I KANË TË
NEVOJSHME KËTO SHËRBIME**

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	REFERENCA LIGJORE	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO
Objektivi 1. Konsolidim i shërbimeve egzistuese dhe ngritje e shërbimeve sociale të reja që adresojnë me efektivitet nevojat e individëve në nevojë për këto shërbime në territorin e Bashkisë						
3.1.1 Ngritje e shërbimeve të reja dhe kalimi i Qendrës “Lira” në Qendër multifunkionale për personat me aftësi të kufizuara	Drejtoria e Shërbimit Social Ekipi i Qendrës Multifunkionale për PAK	2024 2025 2026	Infrastruktura e godinës e përshtatshme për ofrimin e shërbimeve; Shërbimet përbërëse të ngritura dhe funksionale në përputhje me standartet kombëtare për shërbimin specifik; Stafet profesionale të trainuara për ofrimin e	Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" VKM 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitim të tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për	Fondi Social Ministria e Shëndësisë dhe Mbrojtjes Sociale, financim nga donatorët, Bashkia	95,827,960

			shërbimeve sipas tipit të shërbimit; Numri i përfituesve sipas gjinisë të shërbimeve që ofron qendra; Numri i përfituesve të të dy gjinive të shërbimeve të lëvizshme; Numri i familjarëve/ndihmësve të personave me aftësi të kufizuara të përfshirë në shërbimet e qendrës; Numri i personave me aftësi të kufizuara që përfitojnë nga programet e informimit, këshillimit, advokimit;	përfituesit e shërbimit të organizuar” Ligji "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara" Standarti kombëtar për shërbimin në qendër ditore për personat me aftësi të kufizuara Standarti kombëtar për shërbimin në familje për personat me aftësi të kufizuara;		
3.1.5	Zgjerim i partneriteteve në Qendrën “Unë jam si ju”, përmirësim i infrastrukturës egzistuese, zgjerim i shërbimeve egzistuese	Drejtoria e Shërbimit Social Ekipi i Qendrës Multifunkionale për PAK	2024 2025 2026 Infrastruktura e godinës e përshtatëshme për ofrimin e shërbimeve; Shërbimet përbërëse të ngritura dhe funksionale në përputhje me standartet kombëtare për shërbimin specifik; Stafet profesionale të trainuara për ofrimin e shërbimeve sipas tipit të shërbimit;	Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" VKM 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e	Ministria e Shëndësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Bashkia Organizata partnere për formimin profesional	89,557,492

			Numri i përfituesve sipas gjinisë të shërbimeve që ofron qendra; Numri i PAK të rikthyer në familje/komunitet; Numri i personave me aftësi të kufizuara që përfitojnë nga programet e formimit profesional;	shërbimit të organizuar” Ligji "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara" Standarti kombëtar për shërbimin rezidencial për personat me aftësi të kufizuara		
3.1.3 Zgjerimi i shërbimeve në qendrën egjistuese komunitare	Drejtoria e Shërbimit Social Stafi i Qendrës	2024 2025 2026	Infrastruktura e godinës e përshtatëshme për ofrimin e shërbimeve komunitare; Shërbimet përbërëse të ngritura dhe funksionale në përputhje me standartet kombëtare për shërbimin specifik; Stafet profesionale të trainuara për ofrimin e shërbimeve sipas tipit të shërbimit; Numri i përfituesve të shërbimeve që ofron qendra sipas target grupeve dhe gjinisë;	Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" VKM 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar” Standarti Kombëtar i miratuar me Udhëzim të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Fondi Social Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, financim nga donatorët, Bashkia	15,197,760

			Numri i pjesëtarëve të komunitetit rom dhe egjiptian të të dy gjinje të përfshira në programet që ofron qendra;	nr. 911, datë 27.12.2018 “Për miratimin e standartit të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në qendrat komunitare shumëdisiplinore”		
3.1.4 Ngritja e Qendrës Multifunkionale Rajoni 3 Shërbimet për fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje Për të rinjtë e grupmoshës 15-18 vjeç Shërbime psikosociale Asistence ligjore Shërbime të emergjencës Shërbim i levizshëm për zonën rurale <i>Shërbime të specializuara që përmbushin nevojat për të gjithë territorin e Bashkisë (nga viti i dyte i funksionimit të qendrës):</i> Programi i përgatitjes së familjeve kujdestare Program i rehabilitimit për viktimat e abuzimit seksual.	Drejtoria e Shërbimit Social Stafi i Qendrës	2025 2026	Infrastruktura e godinës e përshtatëshme për ofrimin e shërbimeve komunitare; Shërbimet përbërëse të ngritura dhe funksionale në përputhje me standartet kombëtare për shërbimin specifik; Stafet profesionale të trainuara për ofrimin e shërbimeve sipas tipit të shërbimit; Numri i përfituesve të shërbimeve që ofron qendra sipas target grupeve dhe gjinisë; Numri i përfituesve të shërbimeve të emergjencës pranë familjeve në territorin e Bashkisë; Numri i përfituesve të shërbimeve të specializuara	Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" VKM 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar” Standarti Kombëtar i miratuar me Udhëzim të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 911, datë 27.12.2018 “Për miratimin e standartit të ofrimit	Fondi Social Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, financim nga donatorët, Bashkia	25,591,680

Shërbim rehabilitimi për personat me varësi nga droga/alkooli				të shërbimeve të kujdesit shoqëror në qendrat komunitare shumëdisiplinore”		
3.1.5 Shërbimi i këshillimit me telefon	Drejtoria e Shërbimit Social	2024 2025 2026	Marrëveshje me linjën e Këshillimit për Fëmijë ALO 116111; Numri i rasteve të fëmijëve që kanë kërkuar dhe kanë marrë këshillim; Numri i rasteve të fëmijëve të referuar tek NJMF përmes linjës së këshillimit; Marrëveshje me linjën Kombëtare të Këshillimit për viktimat e dhunës në familje; Numri i rasteve të viktimave të dhunës që kanë kërkuar dhe kanë marrë këshillim; Numri i rasteve të viktimave të dhunës të referuara nga Linja tek koordinatori vendor për masa kundër dhunës në familje;	Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" Lligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” Ligji “Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”	Bashkia në partneritet me Linjën e Këshillimit për Fëmijë Alo 116111 partneritet me Linjën Kombëtare të Këshillimit	0
3.1.6 Shërbimi i strehimit social	Drejtoria e Shërbimit Social	2024 2025 2026	Numri i familjeve që kanë përfituar bonus qeraje/strehim social në raport me numrin e familjeve që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara, gra kryefamiljare, viktimat të dhunës në familje, apo individë në nevojë të identifikuar në Planin Social.	Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" Ligji “Për strehimin social”	Bashkia në partneritet me Ministrinë e Financave	0

3.1.7 Shërbim i strehimit të mbrojtur për viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit	Drejtoria e Shërbimit Social	2024	Apartamentet funksionale për çdo rast;	Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror"	Fondi Social Ministria e Shëndësisë dhe Mbrojtjes Sociale, financim nga donatorët, Bashkia	1,800,000
	Koordinatori vendor për masat kundër dhunës në familje	2025	Numri i rasteve të akomoduara dhe që kanë marrë shërbim;	Ligji "për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare"		
		2026	Numri i rasteve që kanë përfituar shërbime rehabilituese dhe riintegruese përmes referimit në shërbimet e qendrave multifunksionale, shërbimin e punësimit etj;	VKM 518, datë 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar"		
				Vendim nr.505, datë 13.7.2011 "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike"		

3.1.8 Shërbim i emergjencës 72 orë për viktimat të dhunës në familje	Drejtoria e Shërbimit Social	2024 2025 2026	Mjediset e emergjencës funktionale për çdo rast;	Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror"	Bashkia	3,506,040
	Stafi i shërbimit Koordinatori vendor për masat kundër dhunës në familje		Numri i rasteve të akomoduar dhe që kanë marrë shërbim; Numri i rasteve që kanë përfituar shërbime rehabilituese dhe riintegruese përmes referimit në shërbimet e qendrave multifunksionale, shërbimin e punësimit etj;	Ligji "për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare" VKM 518, datë 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar" Vendim nr.505, datë 13.7.2011 "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike"		

3.1.9 Shërbim në qendër ditore dhe i asistencës në familje për të moshuarit Shërbim ditor në qendër (nga viti i parë) Shërbim asistencë shtëpiake për të moshuarit (nga viti i dytë) Mbështetje për kujdestarin e të moshuarit/ës (nga viti i tretë)	Drejtoria e shërbimit social Ekipi multisektorial i shërbimit	2024 2025 2026	Shërbimet përbërëse të ngritura dhe funksionale në përputhje me standartet kombëtare për shërbimin specifik; Stafet profesionale të trainuara për ofrimin e shërbimeve sipas tipit të shërbimit; Numri i të moshuarve sipas gjinisë që përfitojnë shërbimin ditor; Numri i të moshuarve që përfitojnë shërbimin në shtëpi; Numri i kujdestarvë të të moshuave të përfshirë në program;	Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" VKM 518, datë 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar" Standarti kombëtar për shërbimin ditor për të moshuarit; Standarti kombëtar për shërbimin në familje për të moshuarit;	Fondi Social Ministria e Shëndësisë dhe Mbrojtjes Sociale, financim nga donatorët, Bashkia	4,908,960
3.1.10 Shërbim i strehimit të mbrojtur për persona me aftësi të kufizuara	Drejtoria e shërbimit social Personeli asistues	2026	Numri i personave me aftësi të kufizuara të ëprfshirë në shërbim; Personeli i trajnuar për këtë formë shërbimi; Modeli i pilotuar dhe rezultatet e tij ndihmojnë për	Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" VKM 518, datë 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre	Fondi Social Ministria e Shëndësisë dhe Mbrojtjes Sociale, financim nga donatorët, Bashkia	2,288,640

			zgjerrimin e shërbimit në periudhën në vijim; Shërbimi garanton jetesën e pavarur dhe ndërveprimin e personave me aftësi të kufizuara me komunitetin, si dhe aksesin e tyre në shërbimet e tjera sipas nevojës;	dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar” Ligji "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara"		
--	--	--	---	--	--	--

QËLLIMI 4. SISTEMI KOMUNITAR I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR PËRMBUSH STANDARTET KOMBËTARE TË CILËSISË DHE PËRSHTATSHMËRISË DHE MBAN NË KONSIDERATË KËNDVËSHTRIMIN E KOMUNITETIT

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	BURIMI I TË DHËNAVE	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO
Objekti 1: Sistemi komunitar i shërbimeve do ti përgjigjet cilësisht nevojave në ndryshim të grupeve vulnerabël						
4.1.1 Monitorimi i cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve	Drejtoria e shërbimit Social Specialisti për monitorimin e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve	2024 2025 2026	Instrumentat e monitorimit të çdo shërbimi janë hartuar në përputhje me standartet kombëtare të shërbimit specifik. Çdo shërbim i ngritur me financim nga Fondi Social monitorohet nga struktura përgjegjëse e Bashkisë;	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Standartet kombëtare për çdo formë shërbimi të kujdesit shoqëror të	Bashkia	0

			Intervistat dhe fokus grupet e realizuara me përfitues të shërbimeve objekt i monitorimit identifikojnë cilësinë e shërbimit nga këndvështrimi i përfituesve Raportet e monitorimit vlerësojnë qartësisht cilësinë dhe përshtatshmërinë e shërbimit dhe rekomandojnë përmirësimet e nevojshme.	ngritur e të financuar nga Fondi Social		
Objektivi 2: Përfshirje e komunitetit në vendimarrjet që lidhen me sistemin komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror						
4.2.1 Rishikimi periodik i Planit Social	Drejtoria e Shërbimit Social	2024 2025 2026	Lista e treguesve që do të mblidhen e përgatitur dhe mban në konsideratë edhe treguesit gjinorë; Frekuenca e mbledhjes së çdo treguesi; Burimi nga do të sigurohet mbledhja e të dhënave; Shkresat zyrtare drejtuar institucioneve që zotërojnë të dhënat e nevojshme; Konsultimet e zhvilluara me institucione publike dhe ofrues shërbimesh;	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetqeverisjen vendore” Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare”	Bashkia	0

			Numri i konsultimeve të zhvilluara me fëmijët; Numri i konsultimeve të zhvilluara me gratë; Numri i konsultimeve të zhvilluara me grupe në nevojë; Ndryshimet e ndodhura në planet dhe buxhetin lokal sipas propozimeve të marra nga konsultimet e zhvilluara;	Ligji “Për aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara” Ligji "për asistencën sociale" Ligji "Për të drejtën e informimit publik" Ligji “Për barazinë gjinore”		
4.2.2 Zëri i përfituesve të shërbimeve dhe komunitetit	Drejtoria e Shërbimit Social	2024 2025 2026	Në faqen elektronike të Bashkisë ka një hapësirë për ti dhënë mundësinë komunitetit të japin këndvështrimin e tyre si mbi shërbimet egzistuese, ashtu edhe shërbimet e reja të nevojshme Në çdo qendër përkujdesi ka një kuti për mendime/ankesa të përfituesve. Drejtoria ka një mekanizëm për ruajtjen e konfidencialitetit të ankuesit	Ligji "Për të drejtën e informimit publik" Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”	Bashkia	0

8. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Monitorimi i zbatimit të të gjithë aktiviteteve të këtij Plani dhe vlerësimi i cilësisë së realizimit do të jetë detyrë kryesore e Drejtorisë së Shërbimit Social të Bashkisë. Për ta lehtësuar këtë proces përveçse çdo aktivitetet i planit është detajuar në përmbajtje në seksionin e Objektivat dhe Aktivitetet, por edhe në Planin e Veprimit për çdo aktivitet janë detajuar si stafet përgjegjëse ashtu edhe treguesit të cilët mundësojnë monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të aktivitetit specifik.

Plani gjithashtu në qëllimin 4 të tij ka parashikuar masa për të garantuar monitorimin dhe vlerësimin. Kjo Drejtori do të ndërmarrë në periudhën shtator-tetor të çdo viti një proces vlerësimi të përmbushjes së Planit për vitin përkatës me qëllim rishikimin vjetor të tij dhe pasqyrimin e ndryshimeve në planin për vitin pasues.

Në vlerësim dhe monitorim të shërbimeve sociale do të ndikojnë gjithashtu edhe Raportet e Monitorimeve dhe Inspektimeve nga struktura kombëtare: Shërbimi Social Shtetëror dhe Inspektoriati Shtetëror për Shërbimet Sociale.

9. PËRMBLEDHJE E BUXHETIT

Për zbatimin e Planit Social 2024-2026 Bashkisë Berat i nevojitet një Fond Social prej 304,275,532 lek ne tre vite. Përlllogaritjet janë kryer të detajuara për çdo aktivitet të Planit dhe pasqyrohen gjerësisht në shtojcën 2 të këtij dokumenti. Në vitin e parë për të zbatuar të gjitha aktivitetet e parashikuara në Plan Bashkisë i nevojitet një fond prej 99,882,297 lek. Rritjet e buxhetit janë graduale për ti dhënë hapësirë Bashkisë që të aplikojë për fonde si pranë Ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen sociale, ashtu dhe pranë donatorëve të mundshëm në këtë fushë.

QËLLIMI	OBJEKTIVI	BUXHETI TOTAL	BUXHETI I BASHKISË VITI 1	HENDEKU I FINANCIMIT VITI 1
<i>Qëllimi 1: Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve, infrastrukturës dhe burimeve financiare të Bashkisë për t'ju përgjigjur cilësisht me shërbime sociale nevojave të komunitetit</i>	<i>Objektivi 1: Personeli përgjegjës për shërbimet sociale në të gjitha nivelet e organizimit do të jetë i përgatitur dhe ka burimet e nevojshme për të përmbushur cilësisht funksionet e tyre ligjore</i>	57,285,600	19,095,200	0
	<i>Objektivi 1: Zgjerim i mekanizmit dhe ndëveprimit për të mundësuar riintegrim ekonomik e social të individëve në situatë vulnerabël</i>	1,404,000	468,000	0
	<i>Objektivi 2. Ngritje e mekanizmit të koordinuar për</i>			

Qëllimi 2. Konsolidim i mekanizmave ndërsektorial egzistues dhe zgjerim me mekanizma të rinj për identifikim dhe adresim efektiv të nevojave të grupeve vulnerabël	adresimin efektiv të nevojave të personave me aftësi të kufizuara	0	0	0
	Objektivi 3. Ngritje dhe funksionim i mekanizmit për veprim të koordinuar për adresimin e nevojave të të moshuarve	0	0	0
	Objektivi 4. Ngritje e mekanizmit lokal për veprim të koordinuar për rehabilitimin e përdoruesve të drogës	0	0	0
	Objektivi 5: Konsolidim i mekanizmave egzistues për identifikimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin e fëmijëve dhe viktimave të dhunës në familje	0	0	0
	Objektivi 6. Identifikim proaktiv dhe menaxhim efektiv i çdo rasti në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje	5,947,400	2,035.800	0
	Objektivi 7. Informim i komunitetit mbi egzistencën e sistemit komunitar të shërbimeve dhe ndërgjegjësim komunitar për të drejtat e çdo individi për të marrë shërbim	960,000	320,000	0
Qëllimi 3. Sistemi i zgjeruar dhe i organizuar i shërbimeve të kujdesit shoqëror do të mundësojë zhvillim, rehabilitim, riintegrim, pavarësinë dhe përfshirjen shoqërore të individëve dhe familjeve që i kanë të nevojshme këto shërbime	Objektivi 1. Konsolidim i shërbimeve egzistuese dhe ngritje e shërbimeve sociale të reja që adresojnë me efektivitet nevojat e individëve në nevojë për këto shërbime në territorin e Bashkisë	238, 678, 532	69,432,737	8,530,560
Qëllimi 4. Sistemi komunitar i shërbimeve të kujdesit shoqëror përmbush standartet kombëtare të cilësisë dhe përshatshmërisë dhe mban në konsideratë këndvështrimin e komunitetit	Objektivi 1: Sistemi komunitar i shërbimeve do të përgjigjet cilësisht nevojave në ndryshim të grupeve vulnerabël	0	0	0
	Objektivi 2: Përfshirje e komunitetit në vendimarrjet që lidhen me sistemin komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror	0	0	0

10. SHTOJCAT

10.1 REFERENCAT

Ligje

- Ligj Nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji Nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"
- Ligji Nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara"
- Ligji Nr. 8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbrit",
- Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik"
- Ligji Nr. 7889, datë 14.12.1994, "Statusi i invalidit".
- Ligj Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës"
- Ligji Nr. 8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e Jetimit"
- Ligji 22/2018 "Për strehimin social"
- Ligji 47/2018 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"
- Ligji "Për barazinë gjinore"

Strategji dhe Plane Kombëtare

Vendim nr. 866, datë 24.12.2019 2020–2023 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale 2020-2023 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj"

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026

Vendim 430, datë 30.6.2021 "Strategjia Kombëtare për barazinë gjinore dhe Plani i Veprimit 2021-2030".

Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 276, datë 12. 5. 2021 "Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025"

VKM në zbatim të ligjit

VKM nr. 518, datë 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar".

Vendim nr. 148, datë 13.3.2018 "Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave këshillimor e koordinues institucional, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave kombëtare e vendore, si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës".

Vendim nr. 882, datë 24.12.2019 "Për mekanizmin e bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike"

VKM Nr.327 datë 2.6.2021, "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës"

VKM Nr.233, datë 10. 4.1998 “Për zbatimin e Ligjit “Për statusin e jetimit”

VKM nr. 578, datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.

VKM nr. 111, datë 23.2.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e fondit social”.

Vendimin nr. 150, datë 20.03.2019 të Këshillit të Ministrave “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”.

Vendim Nr. 148, datë 13.3.2018 “Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave këshillimorë e koordinues institucionalë, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave kombëtare e vendore, si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës”

Vendim nr. 353, datë 12.6.2018 “Për rregullat e funksionimit të grupit teknik, ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve, pranë bashkive dhe njësisve administrative”

Vendim nr. 499, datë 29.8.2018 “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”

Vendim nr.864, datë 24.12.2019 “Për miratimin e dokumentit politik kombëtar për moshimin, 2020–2024, dhe të planit të veprimit për zbatimin e tij”

Vendim Nr.823, datë 6.12.2006, “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit në qendrat ditore”

Vendim nr.822, datë 6.12.2006, “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar, në qendrat rezidenciale dhe ditore”

Urdhra/Udhëzime Ministri

Urdhër nr. 101, datë 21.2.2020 për miratimin e procedurave standarde të veprimit (psv) për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe të dhunës me bazë gjinore nga punonjëset/punonjësit e shërbimeve shëndetësore, në kuadër të bashkëpunimit si anëtarë të mekanizmit të koordinuar të referimit (MKR)

Udhëzim nr. 14, datë 10.5.2016 “Për ofrimin e shërbimit të emergjencës në institucionet e përkujdesit shoqëror të financuara nga fondet e buxhetit të shtetit publik që ofrojnë shërbime të përkujdesit rezidenciale për fëmijët në nevojë”

Udhëzues i “Procedurave për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve në situatë ruge”

Udhëzim nr. 394, datë 9.5.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e komisionit multidisiplinar, si dhe procedurat dhe zbatimin e standardeve të shërbimit të përkujdesjes alternative për fëmijë në familje kujdestare”

Udhëzim nr. 581, datë 18.12.2017, “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencë shtëpiake, për të moshuarit”

Udhëzimi nr.91, datë 27.12.2018 “Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në qendrat komunitare shumëdisiplinore”

Udhëzim nr.597, dt.22.12.17 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencë shtëpiake, për personat me aftësi të kufizuar”

10.2 SHTOJCA BUXHETI I DETAJUAR